



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim

i

Institucionit të Arsimit të Lartë

“Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Brunilda Vërçani

2. Dr. Elira Xhakollari

Dhjetor 2022

**Për Programin e studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Gjermane(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 349 , dt.10.08.1992
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM 913, dt. 09.09.1992
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 297, dt. 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjermanisht / shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	20 PAE / 28PAK
18	Numri i studentëve (për tri vite)	360 studentë të regjistruar
19	Komente / të tjera:	-

## **TË DHËNA TË PËRGGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim, orfrohet nga Departamenti i Gjuhës Gjermane, i cili është njësi bazë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është krijuar në vitin 1991, ndërsa Departamenti i Gjuhës Gjermane në vitin 1992. Aktualisht është një nga departamentet me numrin më të lartë të studentëve në FGJH, rreth 360 studentë për tri vite studimi.

Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është hartuar në përputhje të plotë me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë, datë 22.07.2015.

Programi ofron diplomë bachelor në tri drejtime: Gjuhë dhe Komunikim, Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Gjerman, Përkthim – Interpretim. Njohja e emërtimeve të diplomës në bachelor është miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me shkresë nr 7897, datë 14.12.2005.

Kohëzgjatja e programit të studimit është 3 vite akademike dhe numri i krediteve është 180 ECTS. Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën gjermane dhe shqipe për disa lëndë të caktuara.

Stafi akademik i Departamentit të Gjuhës Gjermane është kualifikuar me tituj e grada shkencore, me përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe i angazhuar vazhdimisht në rritjen e tij profesionale. Pjesë e këtij stafi janë 20 pedagogë me kohë të plotë dhe 20 me kohë të pjesshme.

Që në krijimin e departamentit një mbështetje të vazhdueshme ka dhënë Shërbimi Gjerman për Shkëmbimin Akademik (DAAD), icili angazhonnjë lektor të tij si pjesë e stafit të programit të studimit.

Ky raport i vlerësimit të jashtëm kryhet në kuadrin e akreditimit të këtij programi studimi. Në hartimin e këtij raporti Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit, përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi, në konstatimet e bëra gjatë vizitës në institucion dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të vlerësimit.

## Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: Dr. Brunilda Vërçani dhe Dr. Elira Xhakollari, me mbështetjen e koordinatorit të ASCAL, Msc. Arjana Alija, ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit “Bachelor në gjuhë gjermane me profile” kaloi në disa hapa. Fillimisht grupit të vlerësimit të jashtëm iu vu në dispozicion dosja e plotë e vetëvlerësimit me raportin e vlerësimit të brendshëm dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces.

Pas studimit dhe shqyrtimit të dosjes grupi i vlerësimit të jashtëm hartoi kuadrin e qartësimeve dhe saktësimeve të informacionit të paraqitur në dosje. Për plotësimin dhe konkretizimin e këtyre informacioneve grupit të vlerësimit iu vunë në dispozicion dy ditë për të zhvilluar një vizitë në institucion, e cila kishte një agjendë të përcaktuar qartë.

Vizita në institucion u zhvillua në datat 20 dhe 21 shtator 2022. Gjatë kësaj vizite u zhvilluan takime me dekanen e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, përgjegjësen e Departamentit të Gjuhës Gjermane, grupin e vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Zyrën e Kurrikulave, me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe me sekretarinë mësimore. Në fund të vizitës u realizua një vëzhgim i mjedisve mësimore, laboratorëve, bibliotekave etj.

Gjatë këtyre takimeve grupi i vlerësimit të jashtëm u njoh më tej me organizimin dhe drejtimin e programit të studimit, me burimet financiare, me punën dhe përpjekjet e stafit për kualifikim të mëtejshëm, me përpjekjet për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, me mbështetjen që i ofrohej studentëve dhe me respektimin e të drejtave të tyre, me infrastrukturën dhe logjistikën në funksion të programit të studimit.

Në vijim grupi i vlerësimit hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 02/12/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/163 Prot., datë 02/12/2022, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL nuk përcolli komentet brenda afateve të përcaktuara nga ASCAL, as përmes AMS, dhe as me shkresë zyrtare. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim**

**I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB si dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës në Departamentin e Gjuhës Gjermane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, GVJ konstaton se programi i studimit të ciklit të parë “Bachelor në Gjuhë gjermane me profile” nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Ky program ofrohet në përputhje me misionin e arsimit të lartë, me misionin e Universitetit të Tiranës, të Fakultetit të gjuhëve të Huaja dhe Departamentit të gjuhës Gjermane.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligjit nr 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë. Neni 1”</li> <li>2. DVV Evidenca I.1 Statuti UT, neni 4,5</li> <li>3. DVV Evidenca I.3 Plani strategjik i UT</li> <li>4. DVV Evidenca I.2 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Misioni i FGJH</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare, duke ofruar përgatitje në formimin gjuhësor e shkencor të specialistëve në fushën e mësimdhënies, përkthimit e komunikimit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT, neni 5</li> <li>2. Evidenca I.9 – Rregullore diplomimi e programevestudimore cikli I</li> </ol>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit është hartuar duke u mbështetur në qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë së UT dhe ofrohet në përputhje të plotë me to. Ky konstatim bëhet bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe në vizitën e bërë në institucion.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti i UT-së</li> <li>2. Evidenca I.3 Plani strategjik për Departamentin e juhës Gjermane</li> <li>3. Vizitë në institucion</li> </ol>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se Programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje me synimin për të nxitur zhvillimin ekonomik</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	lokal dhe/ose kombëtar. Hartimi i këtij programi është bërë në përputhje me Statutin e UT-së, në të cilin përcaktohen objektivat për përgatitjen e individëve të kualifikuar, të cilët do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar; në përputhje me strategjinë e zhvillimit 2018-2023 dhe objektivat e programit të studimit.  <i>Referuar :</i> 1.Evidenca I.1 Statuti UT 2.Evidenca I.2 Strategjia e UT-së 3. <a href="https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-2018-2023/">https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-2018-2023/</a> 4.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në gjuhë Gjermane			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të UT-së, ku përcaktohet se studentëve do t'u ofrohen jo vetëm njohuri shkencore që synojnë përgatitjen e profesionistëve, por edhe aftësi që kanë synim përgatitjen e qytetarëve të angazhuar në shoqëri.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje edhe me strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja 2021-2024 dhe me planin strategjik të zhvillimit institucional të Departamentit të Gjuhës Gjermane.</p> <p><i>Referuar:</i>          1.Evidenca I.2 Strategjia e UT-së, pika 1          2.<a href="https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-2018-2023/">https://unitir.edu.al/strategjia-e-zhvillimit-te-universitetit-te-tiranes-2018-2023/</a>          3. Evidenca I.2.2 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja pikat Vizioni dhe Misioni, pikat Vizioni dhe Misioni          4.Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Programit të Studimit</p>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe zbatim të drejtimeve prioritar akademike, të përcaktuara qartë në Statutin e UT-së, në rregulloren e institucionit të Arsimit të Lartë, në Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile.</p> <p>Në të përcaktohet qartë synimi i mësimdhënies me metoda bashkëhore dhe standarde ndërkombëtare, për përgatitjen e specialistëve të lartë, në rastin</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>konkret të specialistëve dhe ekspertëve të gjuhës gjermane, të cilët të jenë të aftë të vënë në praktikë njohuritë e tyre në fusha të ndryshme: mësimdhënie, përkthim, komunikim etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.1, Statuti UT, neni 5 dhe 8</p> <p>2.Evidenca I.4 Rregullore UT, neni 89, pika 1</p> <p>3.Evidenca I.5 Rregullore e brendshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, neni 11 dhe 13</p> <p>4.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, neni 7</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Ligji nr.80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, riorganizuar sipas kërkesave të VKM-së nr.41, datë 24.012018</p> <p>2. Evidenca I.1, Statuti UT</p> <p>3. Evidenca I.4 Rregullore UT</p> <p>4.Evidenca I.5 Rregullore e brendshme e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja</p> <p>5.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b>  <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë objektivat për formimin dhe aftësimin e studentëve, përfshirë kompetencat profesionale, aftësitë dhe njohuritë, që studentët duhet të fitojnë deri në përfundim të programit. Programi i studimit është organizuar duke respektuar udhëzimet e VKM nr. 41 dt 24.01.2018.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile janë të përcaktuara qartë objektivat e programit të studimit. Kompetencat dhe njohuritë që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit gjenden të përcaktuara qartë në përshkrimin e programit të studimit dhe në hartimin e programeve / syllabuseve të lëndëve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.VKM nr.41, datë 24.012018</p> <p>2.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, neni 7</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	3.Evidencat 1,2,3 Syllabuset / Programet e lëndëve 4.Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Programit të Studimit			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.	GVJ konstaton se institucioni ka kryer studime mbi tregun lokal dhe kombëtar të punës. Të dhënat e këtij studimi kanë dalë nga komunikimi me aktorët e tregut të punës të fushës, në kërkesat për punësim dhe mundësitë e punësimit. Institucioni ka komunikuar gjithashtu me një pjesë të studentëve të diplomuar për të marrë të dhëna për punësimin real të tyre dhe <i>në këtë pikë lind nevoja për zgjerimin, forcimin dhe konsolidimin e ruajtjes së të dhënave dhe kontakteve me studentët e diplomuar, me qëllim komunikimin me ta edhe pas përfundimit të studimeve.</i> Gjithashtu institucioni ka kryer një analizë të të dhënave statistikore sipas burimeve zyrtare për tregun e punës në sektorin e mësuesisë, përkthimit dhe turizmit. Nuk ka studim të detajuar mbi punësimin real të të diplomuarve në tregun ndërkombëtar të punës. Në dosjen e vetëvlerësimit përmendet vetëm fakti që shumë të diplomuar e ushtrojnë profesionin në hapësirën gjermanofolëse. (DVV fq.16) Për t'u vlerësuar është organizim i përvitshëm i aktiviteteve për këshillimin për karrierë.  <i>Referuar:</i> 1.Evidenca I.15,16 Studimi i tregut të punës për studentët e Fakultetit të gjuhëve të Huaja 2.Evidenca 1, Raporti i vetëvlerësimit, fq.15			
<b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Programi Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është hartuar dhe ofrohet sipas nevojave të tregut të punës. Në planin strategjik të departamentit evidentohet synimi për garantimin e përfundimit të dijeve, aftësive dhe kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës.Duke analizuar syllabuset e lëndëve të ofruara nga programi i studimit konstatohet se objektivat, struktura dhe përmbajtja e programit e aftësojnë studentin për tregun e punës, duke bërë të mundur lehtësimin e punësimit të tij.  <i>Referuar:</i> 1.Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Programit të Studimit 2.Evidencat 1,2,3 Syllabuset / Programet e lëndëve			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi I.4


**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al






<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Departamenti i Gjuhës Gjermane me profile, me një përvojë 30 vjeçare në fushën akademike, me kapacitet në infrastrukturë dhe strukturat ndihmëse, si edhe burimet e duhura në fushën specifike plotëson çdo kusht për ofrimin e programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile.</p> <p>Stafi akademik është i kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, i punësuar përmes një procedure të konkurimit të hapur, siç është parashikuar në statutin e UT-së dhe siç u konstatua gjatë vizitës në institucion. Stafi është i angazhuar vazhdimisht në kërkimin shkencor, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1.2 Krijimi i Departamentit të Gjuhës Gjermane</li> <li>2. Evidenca I.22 Të dhëna tabelarë për personelin akademik në programin e studimit</li> <li>3. Evidenca I.1 Statuti UT</li> <li>4. Vizita në institucion</li> <li>5. Evidenca I.18 CV e stafit akademik të programit të studimit</li> <li>6. Evidenca III.20 CV e stafit ndihmës akademik</li> <li>7. Evidenca III.39 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik</li> <li>8. Evidenca III.332 Raport vjetor për veprimtaritë e kryera</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësi kryesore që ofron programin e studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Referuar rregullores dhe planit strategjik të programit të studimit dhe rregullores dhe strategjisë së njësisë kryesore, GJVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore, që ofron këtë program studimi. Kodifikimi i programit të studimit është realizuar në përputhje me nenin 86 të ligjit nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe sipas direktivave evropiane referuar Klasifikimit Standard Ndërkombëtar për Arsimin (2013)</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.6 Rregullore e Programit të Studimit</li> <li>2. Evidenca I.3 Plani strategjik për Departamentin e Gjuhës Gjermane</li> <li>3. Evidenca I.2.2 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja</li> <li>4. Evidenca I.5 Rregullore e njësisë kryesore</li> <li>5. Ligji nr. 80/2015</li> <li>6. ISCED-F 2013 <a href="http://uis.unesco.org/en/document/isced-fields-education-and-training-2013-isced-f-2013-manual-accompany-international-7">http://uis.unesco.org/en/document/isced-fields-education-and-training-2013-isced-f-2013-manual-accompany-international-7</a></li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve</p>	<p>Njësi bazë që ofron programin e studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” është Departamenti i Gjuhës Gjermane. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si edhe sipas direktivave dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	udhëzimeve kombëtare e evropiane në Klasifikimin Standard Ndërkombëtar për Arsimin (2013).  <i>Referuar:</i> 1. <i>Ligji nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i> 2. <i>ISCED-F 2013</i> <a href="http://uis.unesco.org/en/document/isced-fields-education-and-training-2013-isced-f-2013-manual-accompany-international-7">http://uis.unesco.org/en/document/isced-fields-education-and-training-2013-isced-f-2013-manual-accompany-international-7</a>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë që ofron programin e studimit "Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile" është Departamenti i Gjuhës Gjermane. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, kjo njësi, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UT-së, me Rregulloren e FGJH-së dhe në zbatim të Ligjit nr80/2015 dhe udhëzimit nr.17, dt. 29.12.2017 të MASR-së, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit dhe marrjes së përgjegjësisë respektive. Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB, GVJ konstaton se për programin "Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile" detyrat dhe përgjegjësitë ndahen mes personelit akademik, i cili përbëhet nga staf akademik i DGJGJ dhe i departamenteve të tjera brenda FGJH si edhe njërive të tjera jashtë FGJH, i organizuar në tri grupe mësimore, ku secili grup ka përgjegjësin e tij. DGJGJ realizon ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë për mbarëvajtjen mësimore. Marrja e përgjegjësisë respektive nga përgjegjësi i departamentit, përgjegjësit e grupeve mësimore, sekretaria mësimore, koordinatori i programit dhe koordinatori për marrëdhëniet me studentët konstatohet qartë në dokumentacionin e shqyrtuar.  Në përputhje me Rregulloren për sigurimin e cilësisë në UT dhe Manualin e cilësisë në UT institucioni, njësia kryesore dhe njësia bazë kryejnë vlerësime të performancës dhe analizë të vazhdueshme të punës së tyre.  <i>Referuar:</i>  1. <i>Evidenca I.1 Statuti UT</i> 2. <i>Evidenca I.5.1 Rregullore e njësisë bazë</i> 3. <i>Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</i> 3. <i>Evidenca I.32 Vendimi për emërimin e koordinorit të programit tëstudimit ; Detyrat e koordinorit të programit</i> 4. <i>Evidenca I71 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i>


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>5.Evidenca I72 Manuali i Cilësisë</p> <p>6.Evidenca I.34 Analizë e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit si edhe me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj, në ndihmë të realizimit të objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe</p> <p>2. Evidenca III.39, fq.6</p> <p>2.Evidenca I.1 Statuti UT</p> <p>3.Evidenca I.5.1 Rregullore e njësisë bazë</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>DGJGJ, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile, harton në mënyrë periodike raportet dhe analizën vjetore të punës së tij, në të cilat përfshihet edhe vlerësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.34 Analizë e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” për nga natyra e studimeve që ofron, nuk përfshin praktikë profesionale në kurrikulën dhe planin e tij mësimor.</p> <p>Praktikat profesionale janë pjesë e Ciklit të dytë të studimeve, Master Shkencor.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>2.Evidenca I.13.6 Planet mësimore</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>UT ofron trajnime profesionale përmes Qendrës së Zhvillimit Rajonal. Informacioni në lidhje me këto trajnime gjendet në faqen web <a href="https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimet-dhe-zhvillimit-profesional/">https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnimet-dhe-zhvillimit-profesional/</a> Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e vetëvlerësimit dhe lundrimi në faqen zyrtare web të UT-së rezulton që aktualisht nuk ofrohen trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile. Për rrjedhojë rekomandohet organizimi i trajnimeve të tilla.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” është i hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për Arsimin e Lartë [Ligji nr. 80/2015 dhe VKM nr.41, dt.24.01.2018]. Ky cikël i parë studimesh është i organizuar në 3 vite akademike me 60 kredite (ECTS) secili, në përfundim të tij studenti pasi i ka shlyer dhedetyrimet përmbyllëse mbledh 180 ECTS [ I.13 sipas Rregullores së diplomimit miratuar me VD të FGJH, nr. 32, dt. 28.03.2022] pajiset me diplomën “Bachelor në Gjuhën Gjermane” me tre profile: Gjuhë dhe Komunikim; Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Gjerman; Përkthim dhe Interpretim. FGJH ka hartuar rregulloren e këtij programi dhe GVB ka plotësuar dosjen e plotë [I.6, I.9, I.13]. Plani mësimor i programit reflekton ndarjen e lëndëve dhe moduleve përkatëse sipas kategorive dhe pasqyron ngarkesën në kredite të shprehur në teori/praktikë, në orë të studimit në auditor (psh. 4 ECTS, 40 orë mësimore: 20 orë seminare/ 20 orë leksione), por në Syllabuse nuk jepen orë të studimit individual të studentit [25 orë për kredit, e specifikuar në Rregulloren e Programit Bachelor “Gjuhë Gjermane” I.6, Neni 15]. Ky program është i organizuar në module të vlerësuara me kreditet përkatëse që variojnë nga 4 ECTS deri 8 ECTS [I.13.6]. Plani mësimor në varësi të profilit ka respektivisht: Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Gjerman 39 lëndë, Përkthim dhe Interpretim 36 lëndë, Gjuhë dhe Komunikim 40 lëndë [I.17].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit e miratuar me VD të FGJH, nr. 32, dt. 28.03.2022.</li> <li>2. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, neni 15.</li> <li>3. Evidenca I.9 – Rregullore diplomimi e programevestudimore cikli I.</li> <li>4. Evidenca I.13.6 Planet mësimore.</li> <li>5. Evidenca I.17 Planet mësimore</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi është hartuar në referencë të nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon formimin e specialistëve të gjuhës gjermane, të Përkthimit dhe të komunikimit duke i pajisur me njohuri mbi gjuhën, kulturën, qytetërimin, letërsinë gjermane, didaktikën, përkthimin dhe interpretimin dhe me shprehje të komunikimit, shkrimit që u mundësojnë</p>

	<p>profesionalizëm në specialitetet mësues, përkthyes/interpret, kritik letrar, udhërrëfyes turistik [Ligji nr.10 247, dt.04.03.2010 për KSHK-në dhe Rregullorja e Njesisë Bazë I.5/1].Këto njohuri reflektohen në lëndë apo module të formimit gjuhësor, letrar dhe kulturor.</p> <p><i>Referuar:</i>  1. <i>Ligji nr.10 247, dt.04.03.2010 për KSHK-në.</i>  2. <i>Evidenca I.5/1 Rregullorja e Njesisë Bazë.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në referencë të kriterit të mësipërm, këto njohuri paraqiten në nivel të përparuar dhe synojnë nxitjen e të menduarit kritik në profilet e përmenduar dhe aftësimin e kërkimit shkencor të studentit. Programi ka për objektiv formimin gjuhësor dhe shkencor me drejtim human, aftësimin për të përdorur në praktikë njohuritë e fituara në fushat e përkthimit, mësimdhënies, komunikimit dhe studimit gjuhësor dhe letrar në ciklet në vijim [I.5/1]. Duke gjykuar nga përbërja e planit mësimor, reflektimi i tij në programet lëndore, nga literatura shoqëruese dhe nga konstatimet gjatë vizitës, mund të thuhet se programi aplikon në praktikë synimet e shprehura në rregulloren përkatëse.</p> <p><i>Referuar:</i>  1. <i>Evidenca I.5/1 Rregullorja e Njesisë Bazë.</i>  2. <i>Vizitë në institucion dt.20, 21 Shtator.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi është hartuar për të ofruar njohuri të thelluara dhe për të zhvilluar kompetencat dhe aftësi si nga ana teorike dhe praktike në tre drejtime shkencore; gjuhësi, studime letrare dhe kulturore, përkthim dhe komunikim. Gjuhësi: me lëndët Hyrje në gjuhësi, Fonetikë, Gramatikë Gjermane (sintaksë, morfologji), Leksikologji, Stilistikë, Histori e gjuhës gjermane, Gjuhësi teksti, Gjuhësi e krahasuar, Gjuhësi e Përgjithshme. Studime letrare e kulturore: Teoria e letërsisë, Letërsi gjermane, Qytetërim, Historia e Gjermanisë, Historia e mesjetës, Letërsi e krahasuar, Albanologji, Letërsi moderne. Përkthim dhe komunikim: Teori Përkthimi, Interpretim (Konsekutiv, Simultan), Teori komunikimi, Semiologji, Antropologji, Pragmatik, Praktikë përkthimi, Përkthim Terminologjik. Si dhe lëndë ndërdisiplinore: Metodologjia e punës kërkimore, Sociolinguistik, Tipologji tekstore, Pedagogji, Psikologji, Gjuha e folur, Gjuha e shkruar, Dëgjim, Didaktika e Gjuhës, Histori arti. Lëndët me zgjedhje për çdo vit akademik të këtij cikli janë 6-8 lëndë të ofruara si mundësi dhe të ndryshme e formuese sipas profileve përkatëse. [I.5/1 neni 11 dhe 12 si dhe I.17]. Ky formim siguron aftësitë bazë të studentit, i cili synon ndjekjen e kurseve më të përparuara studimi në ciklin e dytë.</p> <p><i>Referuar:</i>  1. <i>Evidenca I.5/1 Rregullorja e Njesisë Bazë neni 11 dhe 12.</i>  2. <i>Evidenca I.17 Planet mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Dosja e programit të studimit përmban elementët e mëposhtëm: emërtimin e programit, objektivat formuese, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë përkatës, ngarkesën mësimore dhe organizimin e saj në ECTS (planin mësimor), profilin e programit, kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, kuotat dhe kriteret e pranimit, kodin e etikës akademike,</p>



	<p>detyrimet përmbyllëse, diplomën dhe suplementin [I.13]. Plani mësimor dhe grupet mësimore diskutohen në departament dhe ndryshimet e tij propozohen për miratim në organet më të larta drejtuese, Senati Akademik i FGJH-së [I.5/1 neni 5]. Pra programi i studimit i përmban të gjitha elementët në strukturën e tij siç është përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.13 Rregullorja e diplomimit.</p> <p>2. Evidenca I.5/1 Rregullorja e Njesisë Bazë, neni 5.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi organizohet qartë në veprimtari të klasifikuara sipas kuadrit ligjor të sipërpërmendur. Më poshtë janë kreditet e kategorive të lëndëve të konkretizuara në kreditet përkatëse sipas profileve në Planin mësimor I.17, ndërsa përqindjet për secilën kategori janë të specifikuara në Rregulloren e Programit të Studimit të Gjuhës Gjermane [I.6/1 neni 17]:</p> <p>-Lëndë bazë A (15-20%): Gjuhë Komunikim 40 ECTS, Gjuhë Letërsi 36 ECTS, Përkthim Interpretim 36 ECTS.</p> <p>-Lëndë karakterizuese B (50-55 %): Gjuhë K. 88 ECTS, Gjuhë Letërsi 88 ECTS, Përkthim Int. 80 ECTS.</p> <p>-Lëndë ndërdisiplinore/ integruese C (12.15 %): Gjuhë K. 20 ECTS, Gjuhë Letërsi 24 ECTS, Përkthim Int. 32 ECTS.</p> <p>-Lëndë plotësuese D (10-12 %): Gjuhë K. 24 ECTS, Gjuhë Letërsi 24 ECTS, Përkthim Int. 24 ECTS.</p> <p>-Detyrimet përmbyllëse E (3-5%): Gjuhë K. 8 ECTS, Gjuhë Letërsi 8 ECTS, Përkthim Int. 8 ECTS.</p> <p>Në lidhje me kreditet e lëndëve/moduleve neni 17 i rregullores është përmbushur. Në programin e studimit lëndët dhe modulet përbërse përmbajnë emërtimin, kodin, numrin e krediteve, ngarkesën teori/praktikë, përmbajtjen, literaturën, dhe formën e vlerësimit [I.13].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.6/1 Rregullorja e programit të studimit neni 17.</p> <p>2. Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.2</b></p> <p><b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>FGJH-ja është njësia kryesore përgjegjëse për programin “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” e cila përbëhet nga shtatë njësi bazë, pra departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Gjuhës Gjermane,</li> <li>2. Departamenti i Gjuhës Angleze,</li> <li>3. Departamenti i Gjuhës Franceze</li> <li>4. Departamenti i Gjuhës Italiane</li> <li>5. Departamenti i Gjuhës Spanjolle</li> </ol>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>6. Departamenti i Gjuhës Greke</p> <p>7. Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike</p> <p>Vetë Departamenti i Gjuhës Gjermane, si njësia bazë që ofron programin Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, prej të cilëve 1 njëri është me gradën Profesor, 1 (një) Profesor i asocuar, 13 Doktor shkencash, 1 lektore gjermane e (DAAD), 4 personel ndihmësakademik, një sekretare mësimore. [I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë neni 6 dhe Të dhëna tabelore për stafin akademik II.2]. Departamenti është i organizuar në 3 grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor sipas nenit 5 pika 5 dhe udhëzimin nr.27 dt. 29.12.2017 të MASR-së “Për strukturën e brendshme akademike të IPAL-ve”. [Faqja web e FGJH-së <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a>.] Përbërja, funksioni dhe koordinimi i tyre pasqyrohen në Standardin I.4, Kriteri 1 të këtij raporti. Lektorë të jashtëm, pra personel akademik me kohë të pjesshme janë 28, gjë që reflekton nevojën e Departamentit për tu zgjeruar në organikën e saj. Njësia kryesore dhe bazë përmbushin detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë neni 6.</li> <li>2. Evidenca II.2 Të dhëna tabelore për stafin akademik.</li> <li>3. Faqja web e FGJH-së <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a>.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njesisë përkatëse.</p>	<p>Programi “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” nuk ka praktikë, ajo zhvillohet në ciklin e dytë të studimeve. Ecuria dhe zhvillimi i programit koordinohen ndërmjet përgjegjësit të departamentit, përgjegjësve të grupeve mësimore me karakter kërkimor-shkencor dhe koordinatorit dhe komitetit shkencor për programin e studimit [I.1 dhe I.5/1 neni 10, 11,12]. Koordinatori i programit të studimit dhe komiteti shkencor kombinojnë punën e tyre për hartimin e strategjisë të zhvillimit të programit, rregulloren e programit si dhe dokumentacionin përkatës, ndjek regjistrimin dhe transferimin e studentëve, monitoron realizimin e projekteve si dhe kompetenca të tjera të përshkruara në Vendimin për emërtimin e koordinatorit të programit të studimit [I.32]. Koordinatori i përzgjedhur është njëkohësisht edhe Shef i Departamentit prandaj nga GVJ-ja u rekomandua që të zgjidhej një tjetër anëtar i stafit akademik në këtë pozicion [Tak.4. dt.21]. Përgjegjësat e grupeve mësimore koordinojnë veprimtaritë mësimore të stafit dhe studentëve sipas fushave respektive dhe raportojnë periodikisht tek përgjegjësi i departamentit [I.5.1 neni 11 dhe 12, I.34 Analizë e departamentit të gjuhës gjermane].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT</li> <li>2. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë neni 10, 11, 12.</li> <li>3. Evidenca I.32 Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit.</li> <li>4. Evidenca I.34 Analizë e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe</p>	<p>Në vijim të përshkrimit në Kriterin 1 të këtij Standardi, FGJH dhe DGJGJ përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)




<p>nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>akademike. FGJH ka gjithashtu në përbërje Qendrën e Gjuhëve të Huaja, AUEFIN, Konfuci, që nuk janë njësi bazë [I.1 neni 11]. Struktura akademike e FGJH-së përfshin: Asamblenë e personelit akademik e përbërë nga stafi i të shtatë departamenteve, Dekanati i përbërë nga Dekani dhe 4 zëvendës Dekanët të cilët janë përgjegjës 1 për ciklin e parë të studimeve 1 për ciklin e dytë dhe 1 për ciklin e tretë dhe 1 për projektet dhe supervizim të shefave të departamenteve [I.22, <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a>.] Struktura akademike e DGJGJ ka në përbërje Shefin e Departamentit, 3 grupet mësimore /kërkimore shkencore dhe në strukturën ndihmësakademike përfshihet dhe një laborant [I.5/1 neni 11, 12, I.32].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT neni 11.</li> <li>2. Evidenca I.22 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (për të gjitha vitet).</li> <li>3. <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a>.</li> <li>4. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë neni 11, 12.</li> <li>5. Evidenca I.32. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit.</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Vetë Departamenti i Gjuhës Gjermane, si njësia bazë që ofron programin Bachelor në “Gjuhë Gjermane”, ka në përbërjen e saj 20 anëtarë, personel akademik me kohë të plotë, prej të cilëve 1 njëri është me gradën Profesor, 1 (një) Profesor i asocuar, 13 Doktor shkencash, 1 lektore gjermane e (DAAD), 4 personel ndihmësakademik, një sekretare mësimore.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë</li> <li>2. Evidenca II.2 Të dhëna tabelore për stafin akademik</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Shih. Kriterin 3</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.3</b> <b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>FGJH dhe DGJGJ si njësitë kryesore dhe bazë disponojnë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit “Bachelor Gjuhë Gjermane”. [I.13, I.5/1]. Informacioni i duhur përfshin: Programin e studimit me disiplinat dhe veprimtaritë formuese tëndara sipas kategorive (bazë A, karakterizuese B,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>ndërdisiplinore/integruese C, plotësuese C dhe detyrime përmbyllëse E), të shprehura në kredite, planin mësimor (me lëndët e programit të studimit të ndara sipas kategorive, vite e semestra, kredite, orë të studimit në auditor dhe individual), rregulloren e programit të studimit ku detajohen informacioni mbi programin e studimit, objektivat formuese, karakteristikat e programit të studimit (njohuritë dhe kompetencat e studentëve në fund të programit mësimor, profilprofesional dhe kulturor i tij si dhe mundësitë për punësim), strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues, programin sipas kompetencave, personelin akademik për programin, kriteret e pranimit, programin lëndor (syllabuset). [I.17, I.13, <a href="https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/">https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/</a>]</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit</li> <li>2. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë.</li> <li>3. Evidenca I.17 Planet mësimore.</li> <li>4. <a href="https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/">https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/</a></li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gjuhën Gjermane” është i organizuar në lëndë, module e aktivitete formuese sipas udhëzimeve të VKM-së nr.41 dt.24.01.2018. Veprimtaritë formuese janë të ndara në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje dhe të grupuara sipas kategorive si vijon:</p> <p>A. Lëndë bazë (15%-25% kredite); 8 (tetë) lëndë të detyrueshme; 2 me 8 kredite dhe 6 me nga 4 kredite.</p> <p>B. Lëndë karakterizuese (50%-55%); 21 lëndë të detyrueshme; 1 me 8 kredite dhe 20 me nga 4 kredite.</p> <p>C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese (12%-15%); kryesisht lëndë me zgjedhje, 4 lëndë ose 5 (në varësi të profilit) me nga 4 ose 8 kredite.</p> <p>D. Lëndët plotësuese (10%-15%); 6 lëndë me nga 4 kredite.</p> <p>E. Detyrime përmyllëse (3%-5%); provim përfundimtar (ose temë diplome) 8 kredite [I.13/6, I.24].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. VKM nr.41 dt.24.01.2018.</li> <li>2. Evidenca I.13/6 Planet mësimore.</li> <li>3. Evidenca I.24 Tabelë për numrin e programeve në ciklin e I të II dhe të III të studimeve.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gjuhën Gjermane” dhe 3 profilet e tij janë të organizuar në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas e evropian të përcaktuar në Ligjin nr.80/2015 nenet 6/25, 70, 73, 87/2, VKM nr. 41 dt. 24.01.2018 dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Programi realizohet në tre vite akademike, me nga 60 kredite secili, në përfundim të të cilit studenti mbledh 180 kredite (ECTS) [I.13, I.6/1 neni 16]. Viti akademik është i ndarë në dy semestra me nga 15 javë mësimore secili, në total 6 semestra [I.4 neni 33, I.13].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligjin nr.80/2015 nenet 6/25, 70, 73, 87/2.</li> <li>2. VKM nr. 41 dt. 24.01.2018.</li> </ol>


Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>3. <i>Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).</i>  4. <i>Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit</i>  5. <i>Evidenca I.6/1 Rregullorja e studimit, neni 16.</i>  6. <i>Evidenca I.4 Rregullorja e U'T-së, neni 33.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Planet mësimore përfshijnë informacionin e duhur për ngarkesën mësimore në auditor: leksione, seminare, forma të kontrollit të vazhduar (40 orë në auditor: 20 orë leksione/20 orë seminar). Orët e studimit individual nuk janë të shënuara në planin mësimor, por sipas Rregullores së studimit 1.6/1 neni 15, 1 krediti i takojnë 25 orë studimi individual dhe totali për 1 vit akademik është 60 kredite x 25 orë = 1500 orë studim individual jashtë auditorit të studentit për një vit akademik. Në planin mësimor nuk ka të llogaritura orët laboratorike edhe pse GVJ gjatë vizitës në institucion [Vëzhgim i mjediseve 21.09.2022] konstatuam 5 laboratorë modernë të gjuhës së huaj.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore në auditor (leksione+seminare) është 25 orë mësimore, 50 minutëshe.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të përfituara nga studenti kryhet në forma të ndryshme sipas planit mësimor lëndor (syllabusit): projekte (ese) detyra seminari/kursi (30 %), angazhimi në seminar (10%), provim me shkrim (i ndërmjetëm 20%, përfundimtar 40%). [I.6/1 nenet 25, 26, 27].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Evidenca I.6/1 Rregullorja e studimit, neni 15, 25, 26, 27.</i></li> <li>2. <i>Vizitë në institucion, vëzhgim i mjediseve.</i></li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>DGJGJ çdo vit akademik çon për miratim kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve dhe kuotat e transferimit të studentëve në UT të cilat miratohen nga Senati dhe dërgohen në QSHA. [I.6 neni 31,32] Kuotat e pranimit për vitin akademik 2022-2023 është paracaktuar 90 nga DGJGJ sipas GVB-së edhe pse për vitin pararendës ka qenë 120 dhe të pranuar kanë qenë po 120 studentë, pra kemi një ulje të kuotave, argumentimi është për të seleksionuar dhe përzgjedhur kandidatë cilësorë [Tak.2]. Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka vetëm një student që ka transferuar studimet nga DGJGJ në një fakultet tjetër [I.13/2].</p> <p>Nota mesatare për pranimin në ciklin e parë në FGJH është ulur në 6, 5 referuar Dekanes së FGJH-së [Tak.1, <a href="https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/kriteret-13052018011806.pdf">https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/kriteret-13052018011806.pdf</a>].</p> <p>Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin U-Albania dhe faqet zyrtare të institucionit (FGJH, DGJGJ) në rrjetet sociale [I.13, I.13/2] si dhe përmes fletëpalosjes dhe guidës së studentit të DGJGJ [I.13/3].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, neni 31, 32.</i></li> <li>2. <i>GVB-ja (tak.2. dt.20 Shtator) vizitë në institucion.</i></li> <li>3. <i>Evidenca I.13/2 Kriteret e pranimit, Kuotat e pranimit</i></li> <li>4. <i>Vizitë në institucion, tak.1 me dekanen dhe shefen e departamentit.</i></li> <li>5. <a href="https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/kriteret-13052018011806.pdf">https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/kriteret-13052018011806.pdf</a></li> <li>6. <i>Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit.</i></li> <li>7. <i>Evidenca I.13/3 Fletëpalosjet.</i></li> </ol>




<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programet lëndore (syllabuset) hartohen nga titullari i lëndës sipas modelit standard në shtojcën Nr.2 të VKM-së nr.41 dt.24.01.2018. Ato janë të përditësuara në vijimësi sipas parimeve dhe kriterëve të legjislacionit në fuqi dhe përmbajnë informacion të detajuar për lëndën si: emërtimin/ kodin e saj, titullarin/pedagogun, ngarkesën mësimore (numri i krediteve, orëve mësimore në auditor leskione/seminare), tipologjinë e lëndës, vitin akademik/semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës (e detyrueshme ose me zgjedhje), programin e studimit, adresën elektronike të titullarit/pedagogut të lëndës, temat për çdo orë mësimore, mënyrën e kontrollit të dijeve [shih Kriterin 4] si dhe literaturën bazë dhe të detyrueshme. Në syllabuset nuk janë dhënë orët e studimit individual [Syll. 3, 4, 5].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. VKM-së nr.41 dt.24.01.2018 shtojca nr.2</li> <li>2. Syllabuse 3, 4, 5 (vitet 2021.2022).</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>DGJGJ përmirëson në vijimësi si kurrikulën ashtu edhe programet lëndore me qëllim përshtatjet me ndryshimet ligjore dhe përmirësimin e përmbajtjes, literaturës dhe metodologjisë. [I.34] Propozimet e departamentit për ndryshime në kurrikul (deri në masën 20%) kalojnë në Senatën Akademik. Ndryshimet kryesore në program janë bërë me qëllim përputhjen me legjislacionin në fuqi [I.48].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.34 Analizë e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit</li> <li>2. Evidenca I.48 Proçedura për ndryshimin e kurrikulës.</li> </ol>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në referencë të vlerësimit të Standardit II.3, kriteri 2, mund të thuhet se ngarkesa e programit të studimit “Bachelor në Gjuhën Gjermane” është strukturuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për më tepër, ngarkesa e programit shtrihet në gjashtë semestra 15-javorë me 3-4 javë sezon provimesh në secilin vit akademik. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve shpallen nga Rektori nëpërmjet Strukturës mësimore [I.13/4]. Programi përmban 8-9 lëndë bazë sipas profileve, 17-21 lëndë karakterizuese, 4-5 lëndë ndërdisiplinore/integruese sipas profileve, 6 lëndë plotësuese për të trija profilet. [I13, I.24]. Ngarkesa mësimore javore në</p>



	<p>auditor (leksione, seminare) nuk e tejkalon 25 orë mësimore, në përputhje me 2.1/d në VKM 41 dt.24.01.2018. Sasia mesatare e orëve të studimit për studentin në vit për 60 kredite (25 orë studim individual për kredit=1500 orë nga të cilat jo më pak se gjysma janë orë për studim të pavarur) sipas 2.1/c d në VKM 41 dt.24.01.2018.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13/4 Struktura mësimore.</li> <li>2. Evidenc I.13 Rregullore e diplomimit.</li> <li>3. Evidenca I.24 Tabelë për numrin e programeve në ciklin e I të II dhe të III të studimeve.</li> <li>4. VKM 41 dt.24.01.2018, 2.1/d, 2.1/c d.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi i lëndëve reflekton përmbajtjen e tyre dhe lëndët janë të grupuara sipas emërtimit (profilit) të programit studimor [1.6, Kreu III] dhe ky i fundit përkon me objektivat formuese të programit të studimit: njohuri të përparuara gjuhësore, kulturore dhe letrare në gjuhën gjermane, formim shkencor në fushat e gjuhësisë dhe nëndisiplinave të saj, letërsisë e studimeve kulturore, si dhe formim profesional në mësimdhënie, aftësi komunikimi dhe përkthim/interpretim. [1.6, Kreu III] Komponentët mësimorë të mësimin në auditor (leksione, seminare, ushtrime, si dhe kontroll i vazhdueshëm) nxisin interaktivitetin në auditor midis studentit dhe pedagogut dhe stimulon mendimin krijues e kritik, zhvillon aftësitë komunikuese, njohuritë shkencore dhe profesionale duke i përgatitur ata për tregun e punës [I.13, I.17]. Këto reflektohen në syllabuset lëndore përkatëse. Format e kontrollit si: seminare, ushtrime, projekte (detyra semestrale, ese, detyra seminari), provim i ndërmjetëm, gjatë takimit të GVJ-së me studentët u konstatua se ishin efektive dhe përdorshin gjerësisht nga lektorët [Tak 4.].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, kreu III.</li> <li>2. Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit</li> <li>3. Evidenca I.17 Planet mësimore.</li> <li>4. Vizita në institucion dt.20 Shtator, takimi 4 me studentët e programit bachelor.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Kurrikula është e hartuar në përputhje me profilin e programit. Shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestra dhe vite është kryer në mënyrë të tillë që t'u përgjigjet kompetencave të propozuara të secilit program me synimin e arritjes së rezultateve të të nxënit që u korrespondojnë këtyre kompetencave [I.13]. Vlerësimi në kredite e orë mësimore i disiplinave të ndryshme është realizuar duke ruajtur raportin teori-praktikë: lëndët e detyrueshme vlerësohen me 4 kredite (raporti teori-praktikë: 1 me 1) dhe janë të organizuara në module, lëndët me zgjedhje apo të formimit plotësues vlerësohen me 4 kredite [I.13, I.24 tab.9]. Renditja e lëndëve në semestra (vjetorë) realizuar sipas kësaj vije llogjike: Lëndët e vitit të parë janë kryesisht lëndë bazë dhe plotësuese dhe synojnë kompetencat bazë gjuhësore. Lëndët e viti të dytë janë kryesisht karakterizuese dhe synojnë kompetencat hulumtuese, shkencore dhe përsosjen e shprehive gjuhësore, letrare dhe</p>



	<p>kulturore. Lëndët e vitit të tretë, karakterizuese dhe integruese thellojnë formimin shkencor dhe japin formim profesional në letërsi, komunikim, përkthim dhe mësimdhënie [I.13, I.24 tab.9].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13 Rregullore e diplomimit.</li> <li>2. Evidenca I.24, Tabelë për numrin e programeve në ciklin e I të II dhe të III të studimeve, tab.9.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit është organizuar në referencë të profilit të programit, formimit të specialistëve të gjuhës gjermane [3, I.3]. Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit mësimor në përputhje me përcaktimet për nivelin 6 të KSHK-së, Ligji 10 247 fq.8-9, EQF-së (European Qualifications Framework) dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) [1.8]. Programi reflekton ngjashmëri të konsiderueshme me programe simotra në vend. Mobilitetet e studentëve reflektojnë përputhjen e kësaj strukture me programe të ngjashme ndërkombëtare [V.26].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca 3, Anex Tabelat përmbledhëse (dosja e GVB-së).</li> <li>2. Evidenca I.3 Plani strategjik për departamentin e gjuhës gjermane.</li> <li>3. Ligji 10 247 dt.04.03.2010 për KSHK-nëfq.8-9.</li> <li>4. EQF-së (European Qualifications Framework).</li> <li>5. Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS).</li> <li>6. Evidenca I.8</li> <li>7. Evidenca V.26 Të dhëna tabelore për transferimin e studimeve (5/2.9).</li> <li>8. Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Në referencë të Standardit II.1, kriteri 4 dhe 6 i këtij raporti, mund të thuhet se ndarja e veprimtarive formuese mundëson arritjen e objektivave të programit dhe lehtëson procedurat e transferimit, mobilitetin e studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/moduleve përgjithësisht përditësohen nga titullari i lëndës si në literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse çdo vit. Arsyet që ato rishikohen janë prej nevojave për a) rishikime dhe përditësime në kurrikul [I.48] dhe b) përditësimin e përmbajtjes dhe literaturës së modulit/lëndës. Kjo është e konstatueshme nga syllabuset në dokumentacionin e dorëzuar nga GVB-ja [I.17 dhe I.48]. Gjithashtu nga takimi i zhvilluar në institucion me Shefen e Departamentit si dhe me personelin akademik me kohë të plotë na u theksua fakti se DAAD kishte vendosur në dispozicion të secilit lector, i cili ka qenë më pare pjesë e shkëmbimit akademik, një buxhet vjetor personal prej 200 Eurosh për pasurimin e literaturës [Tak.1 dhe 3] Ndërkohë studentët literaturën e cituar në programet lëndore mund ta aksesojnë në 2 Bibliotekat e Njësisë Kryesore [III.41].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.48 Proçedura për ndryshimin e kurrikulës.</li> </ol>



	<p>2. Evidenca I.17 Planet mësimore.</p> <p>3. Vizitë në institucion, takimi 1 dhe 3 dt.20 Shtator..</p> <p>4. Evidenca III.41 Lista e teksteve e periodikëve në Bibliotekë të shtuara në vitet e fundit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit, përmbajtja e kurrikulës garanton përfitim të dijeve specifike si dhe aftësive e kompetencave të synuara në tre profilet e ciklit të parë: gjuhësi, studime letrare dhe kulturore, përkthim dhe komunikim. Fokusi i studimit është marrja e njohurive bazë, mbi formimin e mësipërm dhe aftësimi i aplikimit të tyre në kërkim dhe në punësim menjëherë pas diplomimit [I.6 neni 6, I13].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit, neni 6.</p> <p>2. Evidenca I13 Ristrukturimi i kurrikulës së programit të ciklit të 1, dt.13.03.2008 (relacion për rektorin e UT-së).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin e dytë, pasi përmbajtja e programit përveç formimit bazë dhe shkencor ofron dhe formim profesional për: komunikim, përkthim dhe mësimdhënie, drejtime (profile) që përvijohen në vitin e 3-të të këtij cikli [I.6 neni 6]. Formimi i marrë në këtë etapë të parë studimesh mundëson kalimin në ciklin e dytë të studimeve sërisht duke i thelluar njohuritë në profilet përkatëse: “Master i Shkencave” në Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik, “Master i Shkencave” në Përkthim dhe Interpretim, “Master Profesional” në Përkthim dhe “Master i Shkencave” në Mësuesi. [<a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a> organigrama]. Profilizimi i përgjigjet kërkesave momentale të tregut për interpretët e kërkuar nga operatorët turistikë dhe kompanitë gjermane që operojnë në vend, përkthyesa të dokumenteve tëndryshme në studio ligjore përkthimi, si dhe nevojat për mësues të gjuhës gjermane në sektorin publik e privat.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit neni 6.</p> <p>2. <a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a> organigrama.</p> <p>3. Evidenca I.15,16 Studim për tregun e punës.</p> <p>4. Evidenca V.27 Të dhëna tabelore përmbledhëse mbi punësimin real të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Programi përmirësohet në vijim të bashkëpunimit të NJBSC me Drejtorinë e Edukimit, Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Veprimtaritë që njësia organizon në bashkëpunim me partneret e tregut në këtë drejtim mund të jenë më të shpeshta e më të shumëllojshme si psh. Panairi i Punës 2022 i organizuar nga FGJH-ja në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë [<a href="https://fgjh.edu.al/?s=Panairi+i+Punës+2022&amp;ref=course&amp;post_type=lp_course">https://fgjh.edu.al/?s=Panairi+i+Punës+2022&amp;ref=course&amp;post_type=lp_course</a>]. Megjithatë fakti që programi (si program i ciklit I) ofron nevojën e studimeve të profilizuara të mëtejshme, e bën të vështirë përthithjen e drejtpërdrejtë të ekspertizës së aktorëve relevantë të tregut. Kjo bëhet nga DGJGJ në vijim të përditësimit të kurrikulave të ciklit të dytë.</p> <p><i>Referuar:</i></p>



	<p>1. <a href="https://fgjh.edu.al/?s=Panairi+i+Punës+2022&amp;ref=course&amp;post_type=lp_course">https://fgjh.edu.al/?s=Panairi+i+Punës+2022&amp;ref=course&amp;post_type=lp_course</a></p> <p>2. Evidenca I.48 Proçedura për ndryshimin e kurrikulës.</p> <p>3. Evidenca I.15,16 Studim për tregun e punës..</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin “Bachelor në Gjuhën Gjermane” me kohë të plotë, dhe me kohë të pjesshme (me kontratë të caktuar dhe të pacaktuar) përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe i përgjigjet nevojave për realizimin e kurrikulës. Momentalisht në DGJGJ janë pjesë e stafit të akademik (të brendshëm dhe të jashtëm) personel i kategorive: profesor, lektor dhe asistent-lektor.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca III.21 Të dhëna tabelore mbi stafin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.</p> <p>2. Evidenca I.22 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (për të gjitha vitet).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik me kohë të plotë i angazhuar në program ka nivelin e duhur të kualifikimit (13 anëtarë të stafit akademik me gradën shkencore Doktor Shkencash dhe 5 MSc., me titujt Profesor 1, Profesor i Asocuar 1) në fushën e programit ku ata drejtojnë, gjithashtu dhe personeli i jashtëm akademik, me kohë të pjesshme (2 Profesorë të Asocuar, 5 anëtarë me gradën Doktor Shkencash, 21 MSc) i angazhuar ka kualifikimin e duhur për mbulimin e fushës së modulit mësimor që i është caktuar [I.22, I.3]. Një anëtar i stafit është folës amtar, lektor i DAAD. Fusha akademiko-kërkimore e personelit akademik të angazhuar në program është në përputhje me natyrën dhe specifikat e moduleve që mbulojnë [I.5/1 nenet 8, 9, 10]. Nga shqyrtimi i CV-ve duket se orientimi i studimeve të tyre pasuniversitare dhe interesave akademike shkencore-kërkimore përkon me ekspertizën në fushat respektive në kurrikul [I.18].</p> <p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik me kohë të plotë zë 70% të totalit, ndërsa personeli akademik me kohë të pjesshme mbulon 30% të ngarkesës mësimore, duke respektuar kështu VKM 418, dt. 10.05.2017 në përmbushje të standardeve për personelin akademik të IAL-së në lidhje me ngarkesën mësimore që duhet të mbulojë stafi akademik.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.22 Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit (për të gjitha vitet).</p>

	<p>2. Evidenca I.3 Plani strategjik për departamentin e gjuhës gjermane</p> <p>3. Evidenca I.5/1 Rregullore e Njesisë bazë, nenet 8,9,10.</p> <p>4. Evidenca I.18 CV-të estafit akademik të programit të studimit.</p> <p>5. Evidenca Aneks Tabelat përmbledhëse</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Ndarja e personelit në grupe mësimore me karakter kërkimor-shkencor, është shembull i një praktike të mirë i cili siguron angazhim akademik të personelit në mbulimin e kurrikulës sipas profilit përkatës. [1.18] Ngarkesa e stafit reflekton balancim në njësi dhe përkon me kuadrin ligjor në fuqi [II.23]. Edhe nga takimi që GVJ-ja pati me personelin akademik me kohë të plotë u konstatua që ngarkesa e orëve mësimore për lektor ishte brenda normës të paracaktuar sipas kategorive respektive të kualifikimit të personelit [Tak.3].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.18, CV-të estafit akademik të programit të studimit.</p> <p>2. Evidenca II.23 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në Gjuhë Gjermane në një vit akademik.</p> <p>3. Vizitë në institucion, takimi i 3-të, dt. 20 Shtator.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Programi nuk përmban komponentë të praktikës profesionale për shkak të natyrës dhe objektivave të tij formuese. Detyrimet përmbyllëse shlyhen me provim përfundimtar ose me punim/tezë diplome që prej vitit të kaluar akademik 2021-2022 sepse më përpara programi i studimit mbyllet me provim përfundimtar [I.17]. Kriteret që duhet të përmbushin studentët të cilët dëshirojnë ta përmbyllin ciklin e parë me punim diplome vendosen dhe shpallen nga Departamenti në fillim të vitit akademik [I.6 neni 21].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.17 Planet mësimore.</p> <p>2. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit neni 21.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e formimit praktik të studentëve si dhe të programit formues DGJGJ ka vënë në dispozicion të studentëve: 5 laboratorë të pajisur me teknologjinë bashkëkohore (2 kabina tëinterpretimit simultan) si dhe 5 Bibliotekat (e FGJH-së dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë). Praninë dhe funksionalitetin e këtyre hapësirave ndihmëse u vërtetua nga GVJ-ja gjatë vizitës në ambjentet e njesisë kryesore dhe bazë [Vizitë në institucion dt.21.09.2022]. Për mirëmbajtjen e të gjitha mjediseve (auditor, laborator dhe biblioteka) është angazhuar personel ndihmës akademik, laborantë dhe specialistë IT-je me formim në gjuhë të huaja. [II.38, Tak. 2]. Aktualisht në programin e Bachelor nuk ofrohen orë të mirëfillta laborator, me programe specifike të mësimin të gjuhës gjermane [Syll. 2021-2022].</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Vizitë në institucion dt. 21 Shtator; vëzhgim i ambienteve, takimi 2.</p> <p>2. Evidenca II.38 Mjediset e fakultetit/ Njësia bazë, tab.16.</p> <p>3. Syllabuse 2021-2022 (1.,2.,3).</p>				
	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="603 1854 778 1921">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="778 1854 970 1921">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="970 1854 1177 1921">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1177 1854 1465 1921">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		





<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>				<b>X</b>
--	--	--	--	----------

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative në bazë të natyrës dhe fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve.</p> <p>Për përdorimin e metodave dhe teknikave inovative institucioni ka organizuar trajnime të stafit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.2 Strategjia e UT-së</p> <p>2. Evidenca III.35 Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit në mësimdhënie e nxënie</p> <p>Evidenca III.42 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit</p> <p>3. Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka të ngritur dhe funksional sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke respektuar legjislacionin për arsimin e lartë dhe statutin e UT-së.</p> <p>Në mënyrë periodike hartohen pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies dhe të lëndëve. Të dhënat e këtyre pyetësorëve përpunohen, analizohen dhe mbi bazën e tyre hartohet plani i masave për në vijim.</p> <p>Tjetër strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse është departamenti, i cili në fund të çdo viti organizon analizën vjetore, pjesë e së cilës është edhe performanca e pedagogut.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.1 Statuti UT</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>2.Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</p> <p>3.Evidenca I.7/2 Manuali i Cilësisë</p> <p>4.Evidenca III.33 Raport vjetor për sigurimin e cilësisë</p> <p>5.Evidenca I.34 Analizë vjetore</p> <p>6.Evidenca III.36 Pyetëtori i studentit</p> <p>7.Evidenca III.37 Pyetëtori i pedagogut</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit periodik përmes anketimeve në fund të çdo semsetri, si edhe duke i përfshirë në procesin e përmirësimit të pyetësorëve.</p> <p>Studentët gëzojnë edhe të drejtën e ankimimit, e parashikuar në rregulloren e UT-së. Ata kanë të drejtë të ngrenë ankimim për rezultatin e vlerësimit, për shkeljen e standardeve akademike, të drejtave të studentëve, cënimin e procesit të mësimdhënies etj. Ankesat e studentëve depozitohen pranë përgjegjësit të departamentit ose dekanit.</p> <p>Studentëve iu njihet e drejta e të qenit pjesë e njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.4 Rregullore e UT-së</p> <p>2.Evidenca I.7/5 Rregullore për funksionimin e NJSBC</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë është NJSBC, e cila bën publike raportin e analizës së pyetësorëve dhe rezultatet e vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në bisedën e zhvilluar me anëtarët e NJSBC-së gjatë vizitës në institucion, GVJ u siguroi që kjo procedurë respekton etikën akademike në zbatim të Ligjit 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</p> <p>2.Evidenca I.7/2 Manuali i Cilësisë</p> <p>3.Evidenca III.33 Raport vjetor për sigurimin e cilësisë</p> <p>4.Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se institucioni inkurajon dhe motivon stafin akademik duke e nxitur të bëhet pjesë e programeve të shkëmbimit akademik me DAAD apo Erasmus+ KA107.</p> <p><i>Megjithatë nga stafi u theksua fakti që numri i shkëmbimeve akademike duhet të vijë në rritje, si rrjedhojë e rritjes së interesit për të qenë pjesë e tyre, si nga ana e stafit ashtu edhe nga ana e studentëve. Edhe në dosjen e vetëvlerësimit vihet në dukje nevoja për shtim të marrëveshjeve institucionale për mobilitetin e stafit dhe të studentëve.</i></p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe</p> <p>2. Vizita në institucion, takimi me dekanen, përgjegjësen e departamentit dhe biseda me stafin akademik</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
<b>Standardi III.2</b>				
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Në zbatim të rregullores së UT-së, të FGJH, të DGJGJ dhe të programit të studimit, Departamenti i Gjuhës Gjermane zbaton forma të mësimdhënies të ndara sipas aktiviteteve specifike: leksione, seminare, detyra kursi, laboratore etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.4 Rregullore e UT-së</li> <li>2.Evidenca I.5 Rregullore e njësisë kryesore</li> <li>3.Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë</li> <li>4.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</li> <li>5.Evidenca I.17 Planet mësimore</li> </ol>			
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	<p>Në mbështetje të procesit të mësimdhënies në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit, stafi akademik i DGJGJ i përfshin studentët në aktivitete të ndryshme si mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Studentët përfshihen në seminare, konferenca e aktivitete të ndryshme shkencore, marrin pjesë në leksione me lektorë të ftuar në bazë të marrëveshjeve me institucionet homologe.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.30/3 Leksione me lektorë të ftuar</li> <li>2. <a href="https://fgjh.edu.al/konferenca-nderkombetare-studentore/">https://fgjh.edu.al/konferenca-nderkombetare-studentore/</a></li> </ol>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	<p>GVJ konstaton se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike përmes organizimit të trajnimeve të ndryshme e të leksioneve të hapura, përmes shkëmbimit akademik dhe mobilitetit të stafit. Gjithashtu rezultojnë se institucioni ka përditësuar bazën laboratorike dhe ka shtuar mjetet e teknologjisë dhe inovacionit për t'i ardhur më pranë personelit në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore në mësimdhënie. Gjatë vizitës në institucion GVJ vëzhgoi ambientet ku zhvillohej mësim dhe konstatoi pajisjen e tyre me mjete të teknologjisë bashkëkohore si tabela interactive, kompjutera modernë, videoprojektorë etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe</li> <li>2. Vizita në institucion/ vëzhgim i mjediseve</li> <li>3. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën</li> </ol>			
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, në vlerësimin e CV-ve të personelit akademik dhe në bisedën e zhvilluar me stafin gjatë vizitës në institucion, rezultojnë që personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent</p>			

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies. Stafit është vazhdimisht i angazhuar në aktivitete kërkimore shkencore, gjë që çon në rritjen e kompetencës së tij mësimdhënëse.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.18 Cv e stafit akademik të programit të studimit</li> <li>2. RVV</li> <li>3. Vizitë në institucion/ bisedë me stafin/ bisedë me dekanen dhe drejtuesen e departamentit</li> <li>4. Evidenca III.332 Raport vjetor për veprimtarinë e kryera</li> <li>5. Evidenca III.331 Raporti i veprimtarisë mësimore kërkimore-shkencore</li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Një nga metodat kryesore për vlerësimin e metodave dhe cilësisë së mësimdhënies është realizimi i pyetësorëve të stafi dhe studentët, pyetësorë të cilët kryehen në mënyrë periodike. Rezultatet e këtyre pyetësorëve analizohen dhe mbi gjetjet e tyre hartohen raporti analitik, në të cilin evidentohen pikat e forta dhe të dobëta, reflektohen mendimet dhe sugjerimet e studentëve dhe përcaktohen masat që do të merren për përmirësimin e dobësive. Raporti mbi rezultatin e pyetësorit u përcillet edhe anëtarëve të personelit akademik, të cilët diskutojnë mbi të në mbledhjet e departamentit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</li> <li>2. Evidenca III.361 Analizë e departamentit mbi pyetësorin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</li> <li>3. Evidenca 36 Raporti i pyetësorit të studentit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda interaktive me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe bërjen tërheqëse të orës së mësimin. Pajisjet teknologjike bashkëkohore, laboratorët, platformat online etj. u vijnë në ndihmë për të realizuar këtë qëllim. Megjithatë sipas raportit mbi pyetësorin e studentëve mbetet ende vend për përmirësim në këtë drejtim.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën e programit</li> <li>2. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</li> </ol>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies parashikojnë dhe përfshijnë punime dhe prezantime nga ana e studentëve si detyra kursi, punë laboratorike, projekte, detyra individuale dhe në grupetj. Të cilat inkurajojnë të studentit ndjenjën e autonomisë dhe nxisin tek ai të menduarit kritik dhe aftësinë për të punuar në grup. Në këtë proces studentit i vjen në ndihmë me udhëzime dhe orientime pedagogu i lëndës, duke synuar në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.17 Plane mësimore</li> <li>2. Evidencat Syllabuse</li> <li>3. Vizita në institucion/ bisedë me studentët</li> </ol>

Shkalla e përbushjes së standardit	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi mësimor e shkencor realizohet nëhapësira deri diku të mjaftueshme për studentët, kjo pasi një pjesë e sallave të seminareve ishin të vogla dhe të ngushta, konstatim ky i bërë gjatë vizitës në institucion. Për sa i përket sallave të leksionit, laboratorëve, sallës së kompjuterave dhe sallave të konferencave GVJ konstatoi se ishin ambiente me hapësirë të mjaftueshme për të realizuar procesin mësimor e shkencor. Të gjitha mjediset (salla leksioni, seminari, laboratorë, biblioteka etj) ishin të pastra e të mirëmbajtura.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizita në institucion / vëzhgim i mjediseve</li> <li>2. Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën e programit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit tëDVV, GVJ konstaton që ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale. Atojanë të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Këtu përfshihen videoprojektorë, kompjutera, tabela interaktive, tavolina smart etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizita në institucion / vëzhgim i mjediseve</li> <li>2. Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën e programit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë infrastrukturën e konsoliduar IT duke përfshirë shërbimin Wi-fi, adresat elektronike zyrtare të stafit dhe të studentëve, laboratorët, qasjen në bibliotekën online etj. Tepër të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p> <p>Duhet theksuar qënë një numër i pakët studentësh shfrytëzon bibliotekën online dhe fizike, konstatim i bërë gjatë bisedës me studentët. <i>Nga stafi akademik duhet të punohet më tepër për nxitjen e studentëve në shfrytëzimin e bibliotekës.</i></p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizita në institucion / vëzhgim i mjediseve/ bisedë me studentët</li> <li>2. Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën e programit</li> <li>3. RVB</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike),</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” është vënë në dispozicion literaturë bazë dhe ndihmëse bashkëkohore, e parashikuar në programin lëndor dhe e miratuar në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>departament. Literatura ofrohet në formë fizike dhe/ose elektronike. Bazuar në kërkesat e stafit akademik literatura zgjerohet, pasurohet dhe vihet në shërbim të studentëve, në mënyrë që të garantojë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidencat Syllabuse</li> <li>2.Evidenca III.41 Lista e teksteve dhe periodikëve në bibliotekë</li> <li>3.Vizita në institucion/ vizita në bibliotekë</li> <li>4.<a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a></li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e FGJH dhe bibliotekat online u garantojnë studentëve të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit, si edhe hapësira komode për përdorim nga studentët. Këto mjedise shërbejnë edhe për aktivitete të ndryshme me studentët.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.DVV</li> <li>2.Evidenca III.41 Lista e teksteve dhe periodikëve në bibliotekë</li> <li>3.Vizita në institucion/ vizita në bibliotekë</li> <li>4.<a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a></li> </ol>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përfaqëta me programin e studimit.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion shërbimin e bibliotekës online(Ulibrary dhe Jstore), nëpërmjet të cilët mund të aksesojnë në çdo kohë libraritë e fushave të ngjashme ose të përfaqëta me programin e studimit.E gjitha kjo vihet në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Ndërkohë që stafi akademik, gjatë bisedës me të, pohon shfrytëzimin e bibliotekave online, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për studentët, një pjesë e të cilëve nuk kishte dijeni për ekzistencën e këtyre bibliotekave. <i>Rekomandohet të punohet më tepër nga ana e stafit për nxitjen e studentëve në shfrytëzimin e bibliotekave online.</i></p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Vizita në institucion/ bisedë me stafin akademik/ bisedë me studentët</li> </ol>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>FGJH dhe rrjedhimisht DGJGJ ka funksionalë laboratorë dedikuar kryesisht përkthim – interpretimit dhe teknologjisë së informacionit, por që shfrytëzohen edhe për zhvillimin e seminareve, detyrave të kursit, studimeve specifike etj. Krahas laboratorëve në dispozicion të studentëve janë vendosur edhe sallat e bibliotekës.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Vizita në institucion / vëzhgim i mjediseve</li> <li>2. Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën e programit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies personeli akademik shfrytëzon edhe platformën Microsoft Teams, e cila ka të integruar edhe platformën E-learning. Çdo anëtar</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>i personelit dhe secili prej studentëve ka adresën e tij në këtë system, ku pedagogu ka mundësinë të ngarkojë material mësimore, ndërsa student të aksesojë në çdo kohë këto materiale.</p> <p><i>Referuar:</i> 1.DVV 2.Vizita në institucion</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe nga shqyrtimi i DVV konstatohet se stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të brendshme të komunikimit si: adresat zyrtare elektronike apo platformën Teams.</p> <p><i>Referuar:</i> 1.DVV 2.Vizita në institucion</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Në zbatim të rregullores së diplomimit studentët përzgjedhin temën e diplomës dhe udhëheqësin shkencor për punimin e diplomës. Në procesin e përzgjedhjes ata mbështeten dhe orientohen nga personeli akademik.</p> <p><i>Referuar:</i> 1.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi e programeve të studimit të Ciklit të parë Bachelor 2. Vizita në institucion</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UT, në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë, në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe të nxitjes së përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies ka ngritur struktura që bashkërendojnë me njësinë kryesore dhe atë bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë. Këto struktura të posaçme janë Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përherëshëm i Kurrikulës.</p> <p><i>Referuar:</i> 1.DVV 2.Evidenca I.75 Mbi ngritjen e NJSBC 3.Evidenca I.13Mbi ngritjen e Komisionit të Përherëshëm të hartimit të kurrikulave</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe</p>	<p>FGJH dhe DGJGJ janë përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Ato nxisin vazhdimisht kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik, sin jë nga mënyrat për rritjen e cilësisë. Përmes hartimit dhe kryerjes së pyetësorëve për stafin dhe studentët, analizës që i bëhet gjetjeve të këtyre pyetësorëve, njohja e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>stafit dhe studentëve me këto gjetje si edhe hartimi i planit të masave synon rritjen e vetëdijes te personeli dhe studentët për cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.7/3 Paketa e instrumentave të cilësisë</li> <li>2.Evidenca III.37 Raporti mbi pyetësonin e personelit akademik</li> <li>3.Evidenca 36 Raporti mbi pyetësonin për studentët</li> <li>4.Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</li> <li>5. Evidenca III.36/1 Analizë e departamentit mbi pyetësonin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Në nivel institucioni është ngritur Drejtoria e Teknologjisë Inovacionit dhe Statistikës, e cila ka hartuar edhe një udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu DGJGJ ka qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme në lidhje me metodat novatore të mësimdhënies.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.DVV</li> <li>2..Evidenca III.35 Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie</li> <li>3. Evidenca III.42 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme, me synim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Gjatë shqyrtimit të CV-ve të tyre konstatohet se stafi ka realizuar botime shkencore në fushën e tyre të ekspertizës, ka marrë pjesë vazhdimisht në aktivitete dhe konferenca shkencore dhe është aktiv në shkëmbime akademike me institucione homologe.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.18 CV të stafit akademik</li> <li>2.Evidenca III.20 CV të stafit ndihmës akademik</li> <li>3. Evidenca III.39 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik</li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i personelit akademik bëhet kryesisht përmes programeve të shkëmbimit në bazë të marrëveshjeve ndër-institucionale. Pjesa dominuese e trajnimeve mbështetet në përpjekjet individuale të personelit, pa pasur mbështetje financiare nga ana institucionale. Ky fakt na u pohua edhe në takimin e zhvilluar me personelin akademik gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.30 marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe</li> <li>2.Evidenca III.39 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit</li> <li>3.Evidenca I.18 CV e stafit akademik</li> <li>4.Evidenca III.20 CV e stafit ndihmës akademik</li> </ol>



<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik është për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja është maksimal. Përgjegjësitë e personelit janë të përcaktuara në Rregulloren e FGJH-së dhe secili nga anëtarët e DGJGJ angazhohet në zbatimin e këtyre përgjegjësiave.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.5 Rregullore e brendshme e FGJH-së</li> <li>2.Evidenca III.35 Strategjia e teknologjisë dhe informacionit në mësimdhënie e nxënie</li> <li>3. Vizita në institucion/ bisedë me stafin</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion konstatohet që personeli akademik është prirur të testojë metoda të reja në mësimdhënie, krahas atyre tradicionale. Këtë e bëjnë përmes projekteve, përdorimit të laboratorëve, të teknologjisë innovative, duke i nxitur studentët të punojnë në grup e të zhvillojnë autonominë e tyre kërkuese.</p> <p>Analiza konkrete që të evidentojnë efektet dhe pritshmëritë e përdorimit të metodave të reja nuk ka.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.DVV</li> <li>2.Vizita në institucion</li> </ol>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësiwe profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në Rregulloren e UT-së, të fakultetit, të departamentit dhe të programit të studimit janë të përcaktuara qartë kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të dijeve dhe aftësiwe. Testimi dhe vlerësimi i njohurive bëhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm, të detyrave të kursit, eseve, provimeve të ndërmjetme dhe provimeve përfundimtare të lëndës të cilët kryhen me shkrim, me gojë, ose të kombinuara. Këto forma kontrolli paracaktohen në syllabusin e lëndës dhe u bëhen të njohura studentëve që në prezantimin e parë të lëndës.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.4 Rregullore UT</li> <li>2.Evidenca I.5 Rregullore e FGJH</li> <li>3.Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë</li> </ol>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>4. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>5. Evidenca Syllabuse</p> <p>6. Vizita në institucion / bisedë me studentët</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo lëndë studentët informohen nga titullari i lëndës mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve të parashikuara në syllabuse.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. DVV</p> <p>2. Vizita në institucion / bisedë me stafin/ bisedë me studentët</p> <p>3. Evidenca Syllabuse</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Ato janë të formave të ndryshme si: vlerësim i vazhdueshëm, projekte, ese, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime finale me shkrim, me goje ose të kombinuara.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca Syllabuse</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<p><b>Standardi III.6</b></p> <p><b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve konstatohet se testimi dhe vlerësimi i dijeve dhe njohurive realizohet gjatë gjithë vitit akademik, përmes vlerësimit të vazhdueshëm, detyrave të kursit, provimeve të ndërmjetme dhe provimit përfundimtar.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca Syllabuse</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Aktualisht në universitetin e Tiranës dhe si rrjedhojë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe në Departamentin e Gjuhës Gjermane nuk është vënë në funksionim ndonjë sistem elektronik për testimin dhe vlerësimin e studentëve. Ky fakt theksohet edhe në DVV, gjithashtu GVJ e konstatoi edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. DVV fq 53</p> <p>2. Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së komisionet e provimeve me së</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, të cilët propozohen nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohen nga dekanin. Njëri prej anëtarëve të komisionit është titullari i lëndës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë  2.Evidenca I.6 Rregullore e njësisë bazë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i dijeve dhe njohurive me shkrim zhvillohet në mënyrë anonime, me sekretim, në zbatim të nenit 48 të Rregullores së UT. Ky fakt na u pohua edhe nga studentët gjatë takimit që u zhvillua me ta. Komisioni i provimit është përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të provimit dhe e monitoron atë me përgjegjësi.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.4 Rregullore e UT-së  2.Vizita në institucion / bisedë me studentët</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive dhe dijeve shoqërohet me komente dhe rekomandime në rastet e lëndëve në të cilat vlerësimi njohurive dhe dijeve kryhet përmes projekteve dhe detyrave të kursit. Në rastet kur vlerësimi përfundimtar kryhet përmes provimit, pas shpalljes së rezultateve studentët kanë të drejtë të shikojnë tezat e korrigjuara dhe komentet mbi vlerësimin mund t'i marrin aty. Gjithashtu atyre u lind e drejta për të paraqitur kontestime dhe ankesa në lidhje me vlerësimin.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.4 Rregullore UT  2.Evidenca I.5 Rregullore FGJH  3.Evidenca I.6 Rregullore e Programit të studimit  4.Vizita në institucion / bisedë me studentët</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në Statutin dhe Rregulloren e UT-së, Rregullorene FGJH-së, Rregulloren e programit të studimit dhe në programet lëndore janë të përcaktuara qartë rregullat mbi të cilat duhet të kryhet provimi, ku rastet e mashtrimit si plagjiatura apo kopjimi janë kategorikisht të ndaluara. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik angazhohen maksimalisht në zbatimin e këtyre rregullave dhe në shmangien e rasteve të shkeljeve të përmendura më sipër.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.1 Statuti UT  2.Evidenca I.4 Rregullore UT  3.Evidenca I.5 Rregullore FGJH  4.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit  5. Evidenca Syllabuse</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e UT-së dhe të programit të studimit.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritë dhe jepen në kohë, sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e UT-së dhe të programit të studimit.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.4 Rregullore UT, neni 49  2.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimi, neni 25</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje</p>	<p>Institucioni, përmes përcaktimeve të qarta në rregulloret përkatëse, u garanton studentëve të drejtën për t'u njohur me vlerësimin dhe për të parë tezen e provimit të korrigjuar. Në rast kontestimi për vlerësimin studenti ka të drejtë të</p>




me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>kërkojë sqarime nga pedagogu i lëndës. Nëse nuk bie dakort me sqarimin ka të drejtë paraqesë një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit. Në vijim ngrihet një komision ad-hoc për shqyrtimin e kërkesës dhe për ndonjë vlerësim të mundshëm pas kësaj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.4 Rregullore UT, neni 50,51</p> <p>2. Evidenca I.5 Rregullore FGJH</p> <p>3. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Procedura mbi ankimimet apo kërkesat është e parashikuar në rregulloret e UT-së, FGJH-së dhe programit të studimit. Çdo kërkesë dhe ankimim shqyrtohet nga një komision i posaçëm, i cili jep edhe vendimin përfundimtar për vlerësimin. E gjithë procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.4 Rregullore UT</p> <p>2. Evidenca I.5 Rregullore FGJH</p> <p>3. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.7</b></p>	
<p><b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile ka si objektiva kryesore formimin e specialistëve të aftë, me kompetenca profesionale, të gatshëm për t'u përballur me nevojat e tregut të punës. Për të realizuar këto objektiva programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë, që të garantojë thellimin e njohurive dhe të zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve. Programi i studimit u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike për fushën e studimit, duke krijuar bazat e duhura për studime të thelluara në ciklin e dytë të studimeve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.3 Plani strategjik i Departamentit të Gjuhës Gjermane</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, përfshirë edhe në gjuhë të huaj. Një pjesë e kurrikulës përbëhet nga lëndë të tipit D, të cilat garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushat e sipërpërmendura.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.17 Planet mësimore</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion konstatohet që stafi akademik analizon punën e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>bërëme studentët gjatë zhvillimit të lëndës. Mbi bazën e këtyre analizave mund të bëhen përditësime të programit lëndor ose ndryshime të kurrikulës.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.DVV fq 56  2.Evidenca I.48 Procedura për ndryshimin e kurrikulës</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Çështjet kryesore të programit të lëndësi prezantohen studentit në orën e parë të mësimit dhe në përfundim të çdo lënde/moduli ato vihen në pah në formën e përsëritjes duke orientuar kështu studentët për implementimin e tyre. Arritja e objektivave formuese të lëndës dhe rezultatet e të nxënit bëhen pjesë e analizës vjetore të punës në department.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.DVV  2. Vizita në institucion/ bisedë me stafin/ bisedë me studentët.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik zhvillon jo vetëm orë mësimore në auditor, por edhe realizon orë të hapura dhe seminare jashtë strukturës së programit të studimit. Organizimi i orëve të hapura bëhet i mundur jo vetëm në nivel departamenti, por edhe në nivel fakulteti dhe universiteti. Realizimi i tyre bëhet duke ftuar lektorë të huaj, ekspertë të fushës, vendas apo të huaj etj.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.30/3 Leksione me lektorë të ftuar</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Stafi akademik e realizon mësimdhënien mbi bazën e kompetencave, të cilat janë të parashikuara në kurrikulën e programit të studimit, duke u dhënë studentëve mundësinë, që në lëndë të caktuara, kryesisht ato karakterizuese, të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë. Në ndihmë të realizimit të këtyre lëndëve janë vënë laboratorë të pajisur me teknologji innovative.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit  2.Evidenca I.17 Planet mësimore  3.Evidenca II.38 Të dhëna mbi infrastrukturën</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara. Këto forma janë të parashikuara në programin lëndor.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.17 Planet mësimore  2.Evidencat Syllabuse</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Organizimi i leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, konferenca studentore dhe Akademia Verore e DGJGJ krijojnë nga ana e personelit akademik një klimë të përshtatshme për studentët, zhvillimin e ideve të tyre innovative, për studime të avancuara kërkimore-shkencore etj.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.30 Leksione me lektorë të ftuar  2.<a href="https://unitir.edu.al/hapja-e-universitetit-veror-ne-fakultetin-e-gjuheve-te-huaja/">https://unitir.edu.al/hapja-e-universitetit-veror-ne-fakultetin-e-gjuheve-te-huaja/</a></p>


<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative e të avancojnë në studimet e tyre kërkimore shkencore duke u ofruar studentëve mundësinë për të qenë pjesë e klubeve studentore, duke i mbështetur edhe financiarisht, gjë që parashikohet në buxhetin vjetor.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.2 strategjia e zhvillimit të FGJH  2.Evidenca III.45 Të dhëna na raporti financiar i FGJH</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>DGJGJ dhe personeli i tij akademik është në përpjekje të vazhdueshme për ndërthurjen e formave të mësimdhënies duke marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me institucione homologe. <i>Këto përpjekje synojnë ecurinë e mëtejshme të mobilitetit të studentëve, i cili duhet të vijë në rritje.</i></p> <p><i>Referuar :</i>  1.Evidenca I.22 Të dhëna për personelin akademik  2.Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar qartë procedura që ndiqet për provimin final ose mbrojtjen e diplomës. Studentët njihen me këtë procedurë përmes takimeve informuese me përgjegjësën e departamentit dhe sekretarinë mësimore.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit  2.Evidenca I.9 Rregullore Diplomimi  3.Vizita në institucion / takim me studentët</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Për realizimin e provimit final hartohet një program, në të cilin përcaktohen disiplinat që do të përfshihen në provim, njohuritë dhe aftësitë që do të testohen, përmbajtja lëndore dhe mënyra e dhënies së provimit. Krahas këtij programi strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik u japin sqarime studentëve mbi organizimin e provimit final. Pedagogët u vënë në dispozicion studentëve materiale të nevojshme për provimin e diplomës.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha</p>	<p>Në provimin final përfshihet testimi i njohurive të marra gjatë tri viteve akademike në lëndët bazë të rëndësishme, lëndët karakterizuese e ndërdisiplinore. Provimi organizohet me gojë dhe me shkrim.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	<p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>2.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Në zbatim të rregullores së programit të studimit dhe të rregullores së diplomimit, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen për provimin përfundimtar, ose për përgatitjen e temave të diplomës, duke u dhënë udhëzime dhe informacione të nevojshme.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>2.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit punimi i diplomës nuk duhet të jetë patjetër me karakter praktik. Megjithatë kur tema është e tillë institucioni asiston studentët në shfrytëzimin e mjediseve të tij specifike si psh.të laboratorëve të përkthimit për studentët që diplomohen në drejtimin Përkthim - Interpretin, të cilët në programin e provimit kanë të përfshirë edhe një provë interpretimi simultan dhe konsektiv. Gjithashtu studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekat fizike dhe virtuale për informacionin e nevojshëm në përgatitjen për provim.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>2.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p> <p>3.DVV</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në rregulloren e diplomimit përfshihet udhëzuesi i punimit të temës së diplomës, i cili përcakton strukturën e temës, gjatësinë, formatimin dhe gjuhën e hartimit të temës. Udhëheqësin e temës e zgjedh vetë studentin. Ai asiston studentin në punimin e temës dhe jep miratimin për ta paraqitur para komisionit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të provimit studentin vlerësohet me notë, vlerësim i cili mbështetet në vlerësimin e provimit përfundimtar që zë 60% të notës dhe në notën mesatare të tri viteve të studimit, që zë 40% të notës.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studentin pajiset me diplomë, e cila është dokument zyrtar. Diploma shoqërohet me listën e notave të fituara gjatë viteve të studimit dhe me suplementin e diplomës, i cili hartohet në përputhje me udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.1 Statuti UT</p>

	2.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit 3.Evidenca V141/ V142 Suplementi i diplomës			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në Statutin e UT-së studentit i vihet në dispozicion në përfundim të studimeve diploma, suplementi dhe lista e notave. Kopje e plote e programit të studimit vihet në dispozicion vetëm me kërkesë të studentit.  <i>Referuar:</i> 1.Evidenca I.1 Statuti UT 2.Vizitë në institucion/ vizita në sekretarinë mësimore			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Institucioni ruan për një kohë të pacaktuar dokumentacionin e studentit dhe i paraqet në rast se kërkohen. Sekretaritë mësimore mbajnë regjistër themeltar, regjistër të arritjeve akademike, regjistër të lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Regjistri themeltar përmban të gjitha të dhënat e studentit të, parashikuara në Udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin.  <i>Referuar:</i> 1.Evidenca III.8 Rregullore e brendshme e degës së sekretarisë mësimore të FGJH-së			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo	Në statutin e UT-së, neni 63 dhe në Rregulloren e UT-së neni 29, është përcaktuar që mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit si edhe të personelit ndihmësimor dhe administrativ, është përgjegjësi dhe kompetencë e Degës së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstaton se kjo zyrë dispononte të dhëna të plota mbi anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të tri dosjeve rastësore të personelit të përfshirë në programin e studimit u konstatua, që dosjet ishin të plota me dokumentacionin e duhur si: ID, CV, kontratë mes palëve, çertifikata të titujve dhe gradave shkencore, dëshmi të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore, dëshmi gjuhësh të huaja etj.</p> <p>Informacioni i brendshëm, të dhënat digjitale dhe ato fizike në arkiva ishin të mirëorganizuar.</p> <p><i>Referaur :</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT</li> <li>2. Evidenca I.4 Rregullore UT</li> <li>3. Vizita në institucion</li> </ol>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Statuti dhe Rregullorja e UT-së e ka të përcaktuar që hartimi dhe zbatimi i procedurave të rekrutimit të personelit akademik është përgjegjësi e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, sektori i Burimeve Njerëzore, i cili në punën e tij mbështetet në bazën ligjore në fuqi, respektivisht në ligjin nr 80/2015.</p> <p>Nevoja për staf paraqitet nga njësia bazë duke iu drejtuar Dekanatis.</p> <p>Njoftimi për shpalljen e vendit të lirë bëhet në faqen zyrtare Web të UT-së, ku pasqyrohen përcaktimi i vendit të punës, dokumentacioni ineqvojshëm për aplikim, kriteret e pranimit, afatet e aplikimit, afatet e shqyrtimit të dosjes së aplikimit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT, neni 67 dhe 68</li> <li>2. Ligji nr 80/2015, neni 64</li> <li>3. Evidenca I.4 Rregullore e UT-së, neni 25,26</li> <li>4. <a href="https://fgjh.edu.al/aplikimet-per-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-2022-2023/">https://fgjh.edu.al/aplikimet-per-personel-akademik-me-kohe-te-pjesshme-2022-2023/</a></li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kërkesa për staf hartohet nga Departamenti e më pas i kalon hierarkisë institucionale, Dekanit e më pas Rektorit.</p> <p>Njësia bazë përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për vendin e punës, ia përcjell ato njësisë kryesore, e cila i dërgon më pas në Rektorat.</p> <p>Njoftimi për punësim të personelit akademik shpallet nga njësia kryesore në faqen zyrtare Web.</p> <p>Procedurën administrative të rekrutimit të personelit akademik e ndjek Dega e Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.1 Statuti UT, neni 67 dhe 68</li> <li>2. Evidenca IV.10/1</li> <li>3. Vizita në institucion</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të</p>	<p>Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit për përzgjedhjen e personelit mbështeten në kriteret të përgjithshme dhe specifike të përcaktuara nga Departamenti dhe të shpallura në kohë.</p>

shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Për vlerësimin e kandidatëve krijohet komisioni ad hoc prej 5 anëtarësh, 3 përfaqësues të njësisë bazë, 1 përfaqësues i një departamenti tjetër i propozuar nga Dekani dhe një përfaqësues i rektoratit.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca IV.10/1 2. Vizita në institucion			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi IV.2</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Gjatë vizitës në institucion, krahas shqyrtimit të DVV, konstatohet që FGJH disponon infrastrukturën e përshtatshme për krijimin e mjedisit dhe mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.  Ambjentet e këtij institucioni përfshijnë auditore mësimdhënie, laboratorë, biblioteka, zyra për personelin akademik dhe ndihmës akademik, laboratorë dhe kabina përkthimi, auditor multifunksional i pajisur me materiale digjitale dhe didaktike, si edhe mjedise të jashtme çlodhëse.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Vizita në institucion			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në takimet e organizuara gjatë vizitës në institucion, në veçanti me stafin akademik, GVJ konstaton se institucioni disponon politika mbështetëse për kualifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik përmes bashkëpunimit me institucione të tjera. UT dhe veçanërisht FGJH kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, që kontribuojnë në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit. <i>Gjatë bisedësme stafin akademik të DGJGJ GVJ konstaton që UT ka parashikuar shumë pak fonde të veçanta në buxhet për rimbursimin e pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare si edhe për botime në bulletine shkencore jashtë vendit.</i>  <i>Rekomandohet shtimi i këtyre fondeve për një mbështetje më të gjerë të stafit në procesin e kualifikimit të mëtejshëm profesional.</i>  <i>Siç e përmendëm më lart, në standardin III.1, kriteri 5 , numri i marrëveshjeve të bashkëpunimi dhe shkëmbimit akademik duhet të vijë në rritje për të plotësuar nevojat e mobilitetit.</i>			



	<p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe  2.Dok.Vizita në institucion</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni dëshmon nxitjen e përdorimit të teknologjive të reja dhe metodave inovative të mësimdhënies, duke vendosur infrastrukturën e nevojshme për realizimin bashkëkohor dhe modern të mësimdhënies përmes vendosjes në përdorim të mjeteve teknologjike: tabela interaktive, videoprojektorë, laboratorë, kompjutera, shërbim internet etj.Gjë që u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Për t'i ardhur nëndihmë personelit akademik institucioni ka hartuar dhe miratuar një udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën  2.Evidenca III.35 Strategjia e teknologjisë dhe inovacionit në mësimdhënie e nxënie  3.Evidenca III.42  4.Vizita në institucion</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni dëshmon angazhimin e të gjitha burimeve njerëzore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, për përmbushjen e objektivave të programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile”</p> <p>Anëtarët e stafit të DGJGJ zotërojnë tituj dhe grada shkencore dhe angazhohen vazhdimisht në rritjen e aktivitetit të tyre shkencor.</p> <p><i>Referuar:</i>  1.Evidenca III.21 Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe në njësinë bazë  2.Evidenca I.18 CV e stafit akademik të programit të studimit</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV dhe në vizitën e kryer në institucion, konstatohet se FGJH/DGJGJ siguron mjediset të mjaftueshme</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse në përputhje me specifikën e programit të studimit. FGJH disponon dy godina për zhvillimin e aktivitetit mësimor, me infrastrukturën e duhur dhe të përshtatshme si auditorë/salla leksionesh e seminaresh, laboratorë, bibliotekë, kënd leximi etj.</p> <p><i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion (krahas informacionit të paraqitur në DVV) GVJ konstatoi se sallat ku zhvillohen leksionet, laboratorët, kabinat e përkthimit, bibliotekat ishin të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat sigurojnë mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Në auditorë gjendeshin tabela interaktive, videoprojektorë, kompjutera, pajisje për web konferenca etj.</p> <p><i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në institucion, konstatoam se FGJH disponon 5 laboratorë të pajisur me mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme teknologjike për zhvillimin e aktivitetit mësimor si edhe për aftësimin teorik dhe praktik të studentëve. Në këto laboratorë zhvillohet mësimi i gjuhës, fonetikës, përkthimit, bëhet prezantimi i detyrave ose punimeve të studentëve etj.</p> <p><i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Sikurse është përmendur në pikën e mësipërme institucioni disponon disa laboratorë, dy prej të cilëve shërbejnë edhe për zhvillimin e lëndëve të informatikës dhe janë pajisur me programet bazë dhe softet specifike profesionale për përkthimin simultan.</p> <p><i>Referuar:</i> Vizita në institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për realizimin e veprimtarive praktike mësimore institucioni zotëron mjediset të përshtatshme dhe të mjaftueshme. Për sa i përket praktikës profesionale ritheksojmë që programi i studimit nuk e përfshin atë në studimet e ciklit të parë Bachelor.</p> <p><i>Referuar:</i> 1. Vizita në institucion 2. Evidenca I.13.6 Planet mësimore</p>



Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile janë katër biblioteka që i ofrojnë studentëve mundësinë e shfrytëzimit të literaturës së nevojshme, përdorimit të tyre si mjedise leximi dhe vendosjen e tyre në dispozicion të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Vizita në institucion
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bibliotekat janë të pajisura me literaturë që i përfshin të gjitha lëndët e programit të studimit (bazuar në vizitën në biblioteka dhe në shqyrtimin e syllabuseve dhe literaturës së kërkuar). Në biblioteka gjenden tekste mësimore, fjalorë, enciklopedi, revista shkencore, libra artistikë CD etj. të përshtatshme për të gjitha veprimtaritë mësimore të programit të studimit.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën 2. Evidenca III.41 Lista e teksteve dhe periodicëve në bibliotekë 3. Vizita në institucion
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni ka krijuar kushte që të gjithë studentët krahas bibliotekës fizike të mund të aksesojnë pa pagesë bibliotekën online U-library, COBISS, JSTORE si edhe në elibrary të ndryshme, në të cilat kanë akses për të marrë informacion me tekst të plotë.  <i>Referuar:</i> 1. DVV fq. 70 2. <a href="https://unitir.edu.al/biblioteka-online/">https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</a> 3. Vizita në institucion
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibliotekat ofrojnë mundësinë e shfrytëzimit të tyre pa kufizime nga ana e studentëve. Ato janë të pajisura me programe kompjuterike dhe pajisje teknike të nevojshme. Ato shërbejnë edhe për organizimin e trajnimeve të ndryshme, për promovime librash, mbrojtje të gradave dhe titujve shkencorë etj.  <i>Referuar:</i> 1. DVV

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>2. <i>Vizita në institucion</i></p> <p>3. <i>Evidenca III.41 Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar njësia bazë harton projektbuxhetin vjetor për pasurimin e bibliotekave me literaturën e nevojshme për programin e studimit. Projektbuxheti dhe kërkesa për përditësim të fondit të bibliotekës hartohet me detaje duke përfshirë titullin e librit, autorin, shtëpinë botuese, sasinë, ISBN dhe ISSN për tekstet mësimore dhe revistat shkencore.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. <i>DVV fq. 71</i></p> <p>2. <i>Vizita në institucion/ vizita në bibliotekë</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Për frekuentimin e bibliotekave janë vendosur orare të përcaktuara në rregulloren e brendshme të bibliotekës. Ato qëndrojnë hapur nga e hëna deri të premten në oraret 8.00-16.30. Në fundjavë bibliotekat janë të mbyllura.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. <i>Evidenca III.41 Rregullore e brendshme e bibliotekës, neni 25</i></p> <p>2. <a href="https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/03/Rregullore-biblioteke.pdf">https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/03/Rregullore-biblioteke.pdf</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Te gjithë informacionin mbi studentët dhe veprimtarinë e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin institucioni e ruan në formë të shkruar (sipas ligjit 80/2015), të ruajtur në sekretarinë mësimore. Janë bërë përpjekje për të vënë në funksionim platformën software e-student, një platformë digjitale moderne, ku studentët dhe pedagogët mund të kenë akses në çdo kohë, <i>por kjo platformë ka ende mangësi në funksionimin e saj.</i></p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. <i>Ligji nr.80/2015, neni 101 Dokumentacioni i procesit mësimor</i></p> <p>2. <i>Evidenca III.8 Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p> <p>3. <i>Vizita në institucion, në sekretarinë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe</p>	<p>Dokumentacioni i personelit të angazhuar në programin e studimit menaxhohet nga Dega e Burimeve njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. <i>Evidenca I.4 Rregullore UT</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	2. Evidenca IV.10 Rregullore e brendshme e punës 3. Vizita në institucion			
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Me gjithë përpjekjen që akses në informacione e dokumente për personelin edhe studentët të sigurohej nga sistemi i menaxhimit E-student, ku secili përdorues mund të menaxhonte në mënyrë të pavarur llogarinë e tij, ende nuk është arritur rezultat konkret dhe funksionim i plotë i këtij sistemi. Për të dërguar informacion tek studentët mbi lëndët që duhet të frekuentojnë, vlerësimet, marrjen e litaraturës etj. Janë vënë në funksionim adresa zyrtare e-mail-i unitir.edu.al. <i>Gjatë bisedës së zhvilluar me stafin akademik gjatë vizitës në institucion doli në pah rëndësia dhe domosdoshmëria e funksionimit të sistemit E-student.</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<i>Siç u theksua më lart sistemi i menaxhimit E-Student ende nuk është në funksionim të plotë.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<i>Ritheksojmë qësistemi i menaxhimit E-Student ende nuk është në funksionim të plotë.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, programe mësimore, orare, data provimesh publikohen në faqen web të UT-së dhe FGJH-së. Informacioni ofrohet në gjuhën angleze dhe atë shqipe.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Pas shqyrtimit të DVV dhe vizitës në institucion u konstatua që UT harton në mënyrë periodike një raport financiar të institucionit, në të cilin pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Duke qenë se UT nuk harton plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi, rekomandojmë që ky plan të hartohet në vazhdim në mënyrë periodike.  <i>Referuar:</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>1.Evidenca III.33</p> <p>2.Evidenca IV.46</p> <p>3.Dokumenta të marra gjatë vizitës në institucion</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV dhe vizitën e kryer në institucion GVJ konstaton se DGJGJ harton një plan buxhetor, në të cilin përfshihen: financimi i burimeve njerëzore, shërbime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, shpenzime për laboratorë, fonde për aktivitete shkencore etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Vizita në institucion/ Biseda me dekanen, përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB UT i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe të jashtëm financiar. Auditit i jashtëm kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe MASR ndërsa auditit i brendshëm kryhet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit.</p> <p>Në dispozicion të GVJ, pasi u kërkua gjatë vizitës në institucion, u vendosën raporte financiare të detajuara me të ardhurat nga tarifat e shkollimit, të kontributeve financiare për student dhe ndarjen e burimeve financiare etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.RVB fq.75</p> <p>2. Dokumenta të marrë gjatë vizitës në institucion</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në dosjen e vetëvlerësimit nuk është paraqitur asnjë dokument mbi analizën financiare që ka bërë UT në fund të çdo viti. Në dosje thuhet vetëm që ky dokument ruhet në arkivën e UT-së.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u kërkua nga ana e GVJ që ky dokument t'u vihej në dispozicion. Pas shqyrtimit të dokumentit GVJ konstaton, se në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Dokumenta të marrë gjatë vizitës në institucion</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në raportet financiare konstatohet që institucioni garanton qëndrueshmëri financiare dhe zotëron kapacitetet e mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare.</p> <p>Burimet e financimit janë Granti nga MASR dhe fondet e siguruar nga tarifat e regjistrimit, shkollimit, shërbime që ofron institucioni.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Dokumenta të marrë gjatë vizitës në institucion</p>





<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, në rregulloren e UT-së, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura, që mbulojnë një cikël të plotë akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Evidenca I.4 Rregullore UT</li> <li>2.Evidenca I.5 Rregullore e njësisë kryesore</li> <li>3.Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë</li> <li>4.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</li> <li>5. Ligji nr 80/2015</li> <li>6.DVV</li> </ol>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Këto procedura dhe politika mbështeten në Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e UT-së, në Rregulloren e FGJH dhe të programit të studimit, si edhe në udhëzimet e MASR.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Ligji nr.80/2015</li> <li>2.Evidenca I.1 Statuti UT</li> <li>3. Evidenca I.5 Rregullore e njësisë kryesore</li> <li>4. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</li> <li>5.<a href="https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-10-date-15-05-2019-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-i-perditesuar/">https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-10-date-15-05-2019-per-procedurat-e-aplikimit-dhe-te-regjistrimit-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-i-perditesuar/</a></li> </ol>

	6. <a href="https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-17-date-30-07-2019-per-disa-shtesa-dhe-dryshime-ne-udhezimin-nr-10-date-15-05-2019/">https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-17-date-30-07-2019-per-disa-shtesa-dhe-dryshime-ne-udhezimin-nr-10-date-15-05-2019/</a>
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	<p>Për zbatimin e kriterëve, procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit institucioni bazohet në statutin e UT-së, në Rregulloren e FGJH dhe të programit të studimit, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, pasi publikohen në faqen zyrtare web të UT dhe FGJH.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <a href="https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf">https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2019/08/Statuti_2018.pdf</a></li> <li>2. <a href="http://www.fgjh.edu.al">www.fgjh.edu.al</a></li> <li>3. <a href="https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/03/Rregullore-e-sekretarise.pdf">https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/03/Rregullore-e-sekretarise.pdf</a></li> </ol>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	<p>Përpara çdo viti akademik institucioni, përkatësisht FGJH dhe Departamenti i Gjuhës Gjermane përcakton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për ciklin e parë të studimeve. Përcaktimi i kuotave dhe kriterëve bëhet duke iu referuar Ligjit Arsimit të Lartë, udhëzimeve të MASR, QSHA dhe RASH si dhe VKM-ve përkatëse.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13.1/ I.13.2 Kriteret e pranimit/ Kuotat e pranimit</li> <li>2. Ligji nr 80/2015</li> <li>3. Vendim Nr. 295, datë 10.5.2019 Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare</li> <li>4. <a href="https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-17-date-30-07-2019-per-disa-shtesa-dhe-dryshime-ne-udhezimin-nr-10-date-15-05-2019/">https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-17-date-30-07-2019-per-disa-shtesa-dhe-dryshime-ne-udhezimin-nr-10-date-15-05-2019/</a></li> <li>5. Evidenca V.25 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve</li> </ol>
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Ato parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj, kuota për program të dytë studimi, për transferim studimesh, për kandidatë me statusin e jetimit, për persona me aftësi të kufizuar, si edhe kandidatë të komunitetit rom dhe ballkano- egjiptian.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.13.1 Kriteret e pranimit</li> <li>2. Evidenca I.13/2 Kuotat e pranimit</li> <li>3. Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</li> </ol>
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publiku dhe të interesuarit marrin informacione dhe udhëzime nga institucioni përmes faqes së tij zyrtare si edhe përmes fushatave promovuese nëpërmjet aktiviteteve informuese me nxënës maturan të, ose fletëpalosjeve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Referuar:</i> 1.DVV 2.Evidenca VI.47 Marketingu përmes faqes së WEB-it 3.Evidenca I.13.3 Fletëpalosjet			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nat përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përveç informimit nga faja zyrtare e internetit e FGJH dhe DGJGJ, e cila është e aksesueshme për të gjithë të interesuarit, informacion i plotë mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentit vihet në dispozicion përmes sekretarisë mësimore, pedagogut të lëndës, adresave të e-mailit dhe stendës së publikimeve të DGJGJ.  <i>Referuar:</i> 1. <a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a> 2. <a href="https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/">https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/</a> 3.Vizita në institucion
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në DVV GVJ konstaton se studentët marrin informacion nga institucioni për kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve. Ata marrin informacion mbi programin e studimit, mbi mundësinë dhe njohjen e krediteve në rast transferimi të studimeve, për regjistrim në program të dytë apo ripranim, si edhe në rastet e mobilitetit të studentëve përmes programit Erasmus. Informacioni mund të merret në department, ose në sekretarinë mësimore.  <i>Referuar:</i> 1.Evidenca I.1 Stauti UT 2.Evidenca I.5 Rregullore e njësisë bazë 3.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit 4.Evidenca III.8 Rregullore e sekretarisë mësimore
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Studentët vihen në dijeni të kriterëve dhe procedurave të vlerësimit të dijeve e sftësive të tyre përmes prezantimit me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik në ditën e parë të fillimit të vitit akademik dhe në vijim nga pedagogu i lëndës ose sekretaria mësimore.  <i>Referuar:</i> 1.DVV 2.Vizita në institucion/ takim me stafin, takim me studentët, vizitë në sekretarinë mësimore

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>2.Evidenca I.9 Rregullore diplomimi</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni informon vazhdimisht si përpara fillimit të vitit akademik ashtu edhe në mënyrë periodike, të gjithë të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit. Ky informacion jepet përmes marketingut në faqen zyrtare web të UT-së, FGJH-së dhe DGJGJ, përmes takimeve të hapura me gjimnazistës ose përmes fletëpalosjeve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.DVV</p> <p>2.Evidenca VI.47 Marketingu përmes faqes së WEB-it</p> <p>3.Evidenca I.13.3 Fletëpalosjet</p> <p>4.<a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a></p> <p>5.<a href="https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/">https://fgjh.edu.al/departamenti-i-gjuhes-gjermane/</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.3**


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit në ditën e parë të fillimit të vitit akademik, në një takim me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik. Në vazhdim studentët i marrin informacionet nga pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.DVV</p> <p>2.Vizita në institucion</p> <p>3.<a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përmes faqes zyrtare web, stendave informuese dhe monitorëve të departamentit, institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacione mbi veprimtaritë formuese, lëndët, modulet etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.DVV</p> <p>2.Vizita në institucion</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>3. <a href="https://fgjh.edu.al/">https://fgjh.edu.al/</a>  4. <a href="https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/Udhezuesi-FGJH.pdf">https://fgjh.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/Udhezuesi-FGJH.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe i trajnon dhe orienton ata drejt tregut të punës përmes pjesëmarrjes në panairin e punës, përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe aktiviteteve të ndryshme. Përmes këtyre aktiviteteve studentëve u krijohet mundësia e lidhjes së kontakteve me punëdhënës të ndryshëm dhe për përgatitjen në futjen e tregut të punës.</p> <p><i>Referuar:</i>  1 <a href="https://fgjh.edu.al/ftesepjesemarrje-ne-panairin-e-punes-2022/">https://fgjh.edu.al/ftesepjesemarrje-ne-panairin-e-punes-2022/</a>;  <a href="https://www.fhf.edu.al/fakulteti-i-historise-dhe-i-filologjise-dhe-fakulteti-i-gjuheve-te-huaja-sot-ne-panairin-e-punesimit/">https://www.fhf.edu.al/fakulteti-i-historise-dhe-i-filologjise-dhe-fakulteti-i-gjuheve-te-huaja-sot-ne-panairin-e-punesimit/</a>;  2. Evidenca VI.11 RRegullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Takimi informues me stafin akademik, faqja zyrtare web e FGJH dhe DGJGJ, sekretaria mësimore, stendat dhe monitorët informues vendosin në dispozicion të studentëve informacion të përditësuar mbi procesin mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> <p><i>Referuar:</i>  1. DVV  2. Vizitë në institucion</p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Krahas mënyrave të informimit të përmenduar në kriterin e mësipërm studentëve u krijohet edhe mundësia e informimit në distancë përmes platformës TEAMS si edhe adresave të tyre zyrtare të e-mailit.</p> <p><i>Referuar:</i>  1. DVV  2. Vizita në institucion</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi. Këto të dhëna ruhen në regjistrat përkatës në sekretarinë mësimore.</p> <p>Numri i studentëve të diplomuar në tri vitet e fundit është:  2019 – 2020 82 studentë  2020 – 2021 73 studentë  2021 – 2022 97 studentë</p> <p><i>Referuar:</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>1.Evidenca V.25 dhe V.27 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve</p> <p>2.Vizitë në instiucion/ vizitë në sekretarinë mësimore</p>												
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit janë si më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>nr.i studentëve të regjistruar</th> <th>çregjistrime</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019 – 2020</td> <td>118</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>2020 – 2021</td> <td>121</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>2021 – 2022</td> <td>120</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table> <p>Referuar:</p> <p>1.Evidenca V.25 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë dhe diplomimin e studentëve</p> <p>2.Vizitë në instiucion/ vizitë në sekretarinë mësimore</p>	Viti akademik	nr.i studentëve të regjistruar	çregjistrime	2019 – 2020	118	11	2020 – 2021	121	7	2021 – 2022	120	9
Viti akademik	nr.i studentëve të regjistruar	çregjistrime											
2019 – 2020	118	11											
2020 – 2021	121	7											
2021 – 2022	120	9											
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Në sekretarinë mësimore ruhet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike, regjistri i lëshimit të diplomave, në të cilët ruhen të gjitha të dhënat për ecurinë e studentëve.</p> <p>Referuar:</p> <p>1.Evidenca III.8 Rregullore e sekretarisë mësimore</p> <p>2. Vizitë në instiucion/ vizitë në sekretarinë mësimore</p>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore ruan dhe menaxhon të dhënat e studentëve në regjistrat përkatës dhe në database të sekretarisë. Këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar, bazuar në statutin e UT-së dhe në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave vetjake.</p> <p>Referuar:</p> <p>1.Evidenca III.8 Rregullore e sekretarisë mësimore</p> <p>2. Vizitë në instiucion/ vizitë në sekretarinë mësimore</p> <p>3.Statuti UT</p>												
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si edhe merr të dhëna mbi punësimin e studentëve të diplomuar. Në këto raporte pasqyrohen edhe masat e marra për përmirësimin e cilësisë së studentëve.</p> <p>Referuar:</p>												

	<p>1.Evidenca III.33 Raport vjetor për sigurimin e cilësisë</p> <p>2.Evidenca I15/16 Studimi i tregut të punës</p> <p>3.evidenca V.27 Të dhëna tabelore mbi punësimin real të studentëve</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në zbatim të ligjit nr 80/2015 dhe sipas Statutit të UT-së studentët përfshihen dhe angazhohen përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese, si në këshillin studentor, senatin akademik, bordin e administrimit, në komisionet e përhershme të UT-së, komisionet të ndryshme në nivel fakulteti ose departamenti etj.</p> <p>Megjithatë duhet theksuar fakti që jo të gjithë studentët kanë informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm mbi përfaqësimin e tyre në organet e sipërpërmendura. Kjo gjë u konstatua gjatë vizitës në institucion, në takimin e zhvilluar me studentët, pjesa dominuese e të cilëve kishin mungesë të plotë informacioni për sa është cituar më lart.</p> <p><i>Rekomandohet që në vijim të gjenden rrugët dhe mënyrat e duhura për të përçuar informacionin te studentët, në mënyrë që edhe ata të dinë që janë të përfaqësuar në organe të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese dhe të ndihen të përfaqësuar në këto organe.</i></p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Ligji nr 80/2015</p> <p>2.Evidenca I.1 Statuti UT</p> <p>3. Evidenca I.4 Rregullore UT</p> <p>4. Vizita në institucion/ Takim me studentët</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në statutin e UT-së, Rregulloren e sigurimit të cilësisë, rregulloren e NJSBCV, në krjimin e GVBësthtë e garantuar përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlersim të procesit të procesit akademik. Në takimin e zhvilluar me GVB gjatë vizitës në institucion ishte e pranishme edhe një student, e cila ishte pjesë e këtij grupi. Ndërsa në takimin me studentët ishte në sallë një student, përfaqësuese e këshillit studentor. Megjithatë siç e përmendëm në kriterin e mësipërm një pjesë e konsiderueshme e studentëve në takim nuk kishin informacion mbi përfaqësimin e tyre në organet vendimmarrëse apo këshilluese.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.1 Statuti UT</p>

	<p>2.Evidenca I.7 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</p> <p>3.Evidenca I.7/2 Manuali icilësisë</p> <p>4.Evidenca I.7/5 Mbi ngritjen e NJSBC-së / Rregullore e NJSBC-së</p> <p>5.Vizita në institucion/ Takim me studentët</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit “Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile” është pasur parasysh ngarkesa akademike e studentëve, duke u bërë një ndarje korrekte e lëndëve në vite akademike, në kreditet përkatëse, në numrin e orëve në auditor dhe atyre të studimit individual e të moduleve teorike e praktike.</p> <p>Gjithashtu janë përfshirë procedurat për njohjen e studimeve të plota ose të pjesshme në rast shkëmbimesh akademike studentore apo mobiliteti. Në këtë rast komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit për transferim verifikon dhe merr vendimin mbi njohjen e plotë ose të pjesshme të studimeve apo kualifikimeve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.13/6 dhe I.17 Plane mësimore</p> <p>2.Evidencat Syllabuset</p> <p>3.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>4.<a href="https://zhtw.facebook.com/FAKULTETiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/1853989304753540/">https://zhtw.facebook.com/FAKULTETiGJUHEVEteHUAJAIUT/posts/1853989304753540/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese garanton marrjen dhe përfshirjen e opinionit të tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë dhe në përmirësimin e programit të studimit. Një rol tërëndësishëm në hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programit të studimit luajnë pyetësorët e studentëve, mbi gjetjet e të cilëve bëhen analiza dhe merren masa për përmirësime të mëtejshme.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.4 Rregullore UT</p> <p>2.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p> <p>3.Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë</p> <p>4.Evidenca I.7/3 Paketa e instrumenteve të cilësisë</p> <p>5.Evidenca III.36/1 Analizë e departamentit mbi pyetësorin e studentit</p> <p>6.Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave të programit të studimit</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u jepet mundësia e dhënies së mendimit mbi ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit, si edhe mundësia e ankimimit të rezultatit rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës. Kjo e drejtë e tyre është e përcaktuar në rregulloren e UT-së, në rregulloren e njësisë bazë dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.4 Rregullore UT</p> <p>2.Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë</p> <p>3.Evidenca I.6 Rregullore e programit të studimit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	4. Vizita në institucion/ takim me studentët			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	GVJ kërkoi gjatë vizitës në institucion informacione mbi procedurat dhe njësitë për informimin e studentëve dhe mësoi se në shërbim të informimit të studentëve ishin sekretaria mësimore, zyra e përgjegjëses së departamentit, zyra e këshillimit të karrierës, faqja zyrtare web e fakultetit dhe departamentit të gjuhës gjermane, si edhe stendat dhe monitorët informues në ambientet e fakultetit.  <i>Referuar:</i> <i>1. Vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Siç përmendet në kriterin e mësipërm institucioni angazhohet në shërbim të informimit, këshillimit dhe asistencës së studentëve përmes sekretarisë mësimore, përgjegjëses së departamentit, faqes zyrtare etj. Një rol të veçantë në këtë aspekt luajnë edhe pedagogët e programit të studimit, të cilët përcjellin te studentët informacione e këshilla të nevojshme.  <i>Referuar:</i> <i>1. Vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Institucioni ka funksionale dhe u ofron shërbim studentve përmes zyrës së këshillimit të karrierës, e cila mirëpret këshillon dhe orienton studentët në procese të ndryshme.  <i>Referuar:</i> <i>1. Evidenca VI.11 Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës.</i> <i>2. Vizita në institucion</i>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e këshillimit të karrierës krijon një databasetë dhënash mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, u ofron studentëve shërbime në lidhje me edukimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës dhe mban përgjegjësi për të informuar të gjitha palët e interesuara.  <i>Referuar:</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	1. Evidenca VI.11 Rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës. 2. Vizita në institucion			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UT ka të ngritur dhe funksional Sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, që e ka realizuar përmes ngritjes së Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), i cili varet nga Senati Akademik. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 8 pedagogë dhe 3 studentë, ku çdo fakultet, përfshirë FGJH, përfaqësohet nga një anëtar/pedagog. Njësia kryesore, FGJH, ka të ngritur Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, me 7 anëtarë, 5 pedagogë të përhershëm dhe 2 studentë. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca I.1 Statuti UT 2. Evidenca I.7/2 Manuali i cilësisë 3. Evidenca I.7/4 Vendimi për ngritjen e njësisës brendshme të cilësisë 4. Evidenca I.7/5 Rregullore për funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në FGJH 5. Vizita në institucion
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UT, FGJH, DFGJGJ kanë të ngritura dhe funksionale strukturat përkatëse për të ndjekur procesin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj. DGJGJ përfshin në procesin e sigurimit të cilësisë të gjithë anëtarët e saj, të organizuar në grupe pune, në komitete Shkencore dhe duke përcaktuar koordinatore programesh. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë përfshihen edhe studentët, përmes diskutimeve me ta, apo anketimeve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.32</li> <li>2. Evidenca I.7/5 Mbi ngritjen e njësive të brendshme të cilësisë</li> <li>3. Evidenca Raport mbi pyetësorin e studentit</li> <li>4. Vizita në institucion</li> </ol>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Vlerësimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike përmes procesit të jashtëm të akreditimit nga agjensitë përkatëse akredituese.</p> <p>Ky proces realizohet në bashkërendim me procesin e vetëvlerësimit të njësive bazë.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion për shqyrtim GVJ konstaton, se DGJGJ ndjek politika të qarta dhe procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron.</p> <p>Disa nga procedurat për zhvillimin e departamentit dhe rritjen e cilësisë janë: kryerja e veprimtarive kërkimore e shkencore, përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së kurrikulave, përmirësimi i infrastrukturës, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe, kryerjes së anketimeve etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit</li> <li>2. Evidenca I.30 Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe</li> <li>3. Evidenca I.48 Procedura për ndryshimin e kurrikulës</li> <li>4. Evidenca III.36 Analizë e departamentit mbi pyetësorin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</li> <li>5. Evidenca III.39 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik</li> <li>6. Evidenca VI.46 Informacion për buxhetin</li> </ol>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>
<p><b>Standardi VI.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>		<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>		
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>		<p>Monitorimi, shqyrtimi, mbikëqyrja e rishikimi i programit të studimit kryhet nga njësi të posaçme. Ky proces fillon në nivel departamenti, kalon në njësinë kryesore, i përcillet më pas Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë dhe në vijim kalon në Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë pranë UT. Vendimi përfundimtar i përket Senatit Akademik të UT-së.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.7.2 Manuali i cilësisë së UT-së</li> </ol>		


<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, vizitën në institucion dhe takimin me stafin konstatohet, se institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të parë duke vlerësuar gjithë ecurinë e programit të studimit, nisur që nga respektimi i kriterëve të pranimit të studentëve dhe rekrutimit të stafit, performanca e personelit, rritja e veprimtarisë kërkimore shkencore, përmirësimi i infrastrukturës, identifikimi i nevojës për përmirësime, ndryshime e përditësime të kurrikulës, ndryshim apo përmirësim të programit të studimit si edhe identifikimin e nevojës për programe të reja studimi.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.5 Rregullore e njësisë kryesore</li> <li>2. Evidenca I.5/1 Rregullore e njësisë bazë</li> <li>3. Evidenca I.13.2 Kriteret e pranimit; Kuotat e pranimit</li> <li>4. Evidenca I.48 Procedura për ndryshimin e kurrikulës</li> <li>5. Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave të programit të studimit</li> <li>6. Evidenca I.7/2 Manuali i Cilësisë</li> <li>7. Evidenca II.38 Të dhëna për infrastrukturën</li> <li>8. Evidenca III.39 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik</li> </ol>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Vlerësimi i ecurisë dhe mbarëvajtjes së programit të studimit realizohet kryesisht me anë të pyetësorit të vlerësimit nga personeli akademik, pyetësor i cili plotësohet çdo vit nga personeli akademik. Mbi gjetjet e pyetësorit hartohet një raport përmbledhës.</p> <p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit Departamenti i Gjuhës Gjermane dhe takimit me stafin akademik organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin e programit të studimit, rregullores së tij, duke vlerësuar misionin, profilin, planin mësimor, rezultatet e të nxënit, infrastrukturën, teknologjinë në ndihmë të mësimdhënies, nivelin e kualifikimit të stafit, bashkëpunimin me institucionet homologe, si edhe vlerëson mendimin e studentëve.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca I.7/2 Manuali i cilësisë</li> <li>2. Evidenca III.37 Raporti përmbledhës mbi pyetësorin "Formular vlerësimi nga personeli akademik"</li> <li>3. Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave formuesetë programit të studimit</li> </ol>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve janë të dokumentuara në formë raportesh dhe u paraqiten autoriteteve përgjegjëse.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Evidenca Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave formuesetë programit të studimit</li> <li>2. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</li> </ol>



	3. Evidenca III.37 Raporti përmbledhës mbi pyetësorin "Formular vlerësimi nga personeli akademik"			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në raportet e vlerësimit përfshihen të gjithë treguesit e nevojshëm: rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, masat e ndërmarra për përmirësim të cilësisë.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave formuesetë programit të studimit 2. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë 3. Evidenca III.37 Raporti përmbledhës mbi pyetësorin "Formular vlerësimi nga personeli akademik"			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetëvlerësimit konstatohet se njësia bazë që ofron programin e studimit "Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile" e kryen vlerësimin e brendshëm të programit të studimit duke e koordinuar me procesin e akreditimit institucional dhe duke e përfshirë këtë vlerësim në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit.  Për realizimin e vlerësimit të brendshëm është ngritur dhe funksionon Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, një organizëm adhoc, i përbërë nga 4 pedagogë me kohë të plotë dhe një përfaqësues nga studentët.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT 2. Vizita në institucion, takim me GVB
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Bazuar në shqyrtimin e DVV, evidenca I.7/3 dhe në takimin e zhvilluar me GVB u konstatua se për kryerjen e vlerësimit institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme me specifikën e programit të studimit "Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile", i ofruar nga DGJGJ pranë FGJH.  <i>Referuar:</i> 1. Evidenca I.7/3 Paketa e instrumenteve të cilësisë 2. Vizita në institucion, takim me GVB

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>DGJGJ, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, të cilat sigurojnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të të mësuarit etj.</p> <p>Vlerësimi kryhet nga drejtuesi i njësisë bazë, nga kolegët dhe studentët.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.7/2 Manuali i cilësisë</p> <p>2.Vizita në institucion ; Takim me stafin</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>DGJGJ, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorët e studentëve e të personelit akademik.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.7/3 Paketa e instrumenteve të cilësisë</p> <p>2.Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</p> <p>3.Evidenca III.36.1 Analizë e departamentit mbi pyetësorin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</p> <p>4.Evidenca III.37 Raporti përmbledhës mbi pyetësorin “Formular vlerësimi nga personeli akademik”</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>				
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit, krahas njësisë bazë dhe asaj kryesore, angazhohet Komisioni i Përhershëm i Kurrikulave, i miratuar nga Senati Akademik dhe Drejtorja e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, të cilët operojnë në bashkëpunim të ngushtë me KPSSC-në.</p> <p>Nuk përmenden aktorë të jashtëm të përfshirë në procesin e sigurisë së cilësisë së programit.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjitha palët e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete të përcaktuara nga institucioni.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1.Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</p>			



	<i>2. Vizita në institucion, takim me GVB</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile është e garantuar përfshirja e njësisë bazë dhe asaj kryesore.</p> <p>Njësia bazë dhe drejtuesi i saj mbartin përgjegjësi konkrete në procesin e vlerësimit të cilësisë. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e udhëzimeve dhe detyrave të përcaktuara.</p> <p>Departamenti ka funksional GVB, i cili operon në kuadrin e akreditimit institucional.</p> <p>Njësia kryesore FGJH,ku perfshihet DGJGJ,garanton kushtet e duhura për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit të ofruar nga DGJGJ.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p><i>1.Evidenca I.7/1 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT</i></p> <p><i>2.Evidenca I.7/2 Manuali i cilësisë</i></p> <p><i>3. Vizita në institucion, takim me GVB</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Departamenti i Gjuhës Gjermane i ka ndarë përgjegjësitë për vlerësimin e brendshëm dhe sigurinë e cilësisë të të gjithë anëtarët e tij. Secili prej tyre i nënshtrohet procesit të vlerësimit si edhe merr pjesë në të duke shmangur çdo lloj pabarazie dhe duke respektuar integritetin akademik të secilit.</p> <p>Në takimin me përfaqësuesit e Departamentit gjatë vizitës së kryer në institucion vlerësohet angazhimi i të gjithë stafit në procesin e vlerësimit si edhe respektimi i fushave të ekspertizës së gjithësecilit.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, i cili përbëhet nga 11 anëtarë, që zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p><i>1.Evidenca I.1 Statuti UT, neni 41</i></p> <p><i>2.1.7/1 Evidenca Rregullore për sigurimin e cilësisë, neni 15,16</i></p> <p><i>3. Vizitë në institucion; Takim me NJSBC</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë**

**Kriteret**


**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>E gjithë veprimtaria në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pasqyrohet në raportet e NJSBC-së, të cilat miratohen nga dekani dhe publikohen në faqen zyrtare të FGJH-së.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.7/5 Rregullore për funksionimin e njesive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në FGJH</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit publikohen të përmbledhura dhe në formë statistikore informuese, duke garantuar mosçënimin e të dhënave personale, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike.</p> <p>Ky informacion u ofrohet subjekteve që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në DGJGJ.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.7/2 Manuali i Cilësisë</p> <p>2. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</p> <p>3. Evidenca III.37 Raport mbi pyetësin "Formular vlerësimi nga personeli akademik"</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit në DGJGJ shoqërohen me një plan masash, në të cilin përfshihen synimet për përmirësimin e dobësive të evidentuara si: përmirësim i rezultateve të arritura, i performancës së personelit, etj.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca III.36/1 Analizë e departamentit mbi pyetësin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</p> <p>2. Evidenca Raporti i pyetësit të studentit</p> <p>3. Evidenca III.37 Raporti nisur nga pyetësi i personelit akademik</p> <p>4. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Veprimtaritë për vlerësimin e cilësisë dhe përmirësimin e saj dokumentohen, analizohen dhe vlerësohen duke siguruar efektivitetin e tyre.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. Evidenca I.3 Plani strategjik për DGJGJ</p> <p>2. Evidenca III.36/1 Analizë e departamentit mbi pyetësin për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies</p> <p>3. Evidenca Raporti i pyetësit të studentit</p> <p>4. Evidenca III.37 Raporti nisur nga pyetësi i personelit akademik</p> <p>5. Evidenca III.33 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>DGJGJ informon dhe ndërgjegjëson personelin për sigurimin dhe përmirësimin e programit të studimit përmes diskutimeve të vazhdueshme apo mbledhjeve periodike.</p> <p><i>Referuar:</i></p> <p>1. DVV</p> <p>2. Evidenca I.34 Analizë e departamentit mbi arritjen e objektivave të programit të studimit.</p> <p>3. Vizitë në institucion. Bisedë me stafin dhe studentët.</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; gjuhë dhe komunikim, gjuhë letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës, përkthim dhe interpretim, të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Të gjithë elementët formues të programit mundësojnë përgatitjen e specialistëve me formim gjuhësor e shkencor dhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë, të gatshëm për tregun e punës e për të nxitur më tej zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar.
2. Kurrikula e pasur e programit të studimit u hap rrugën studentëve për studime të mëtejshme të thelluara në programet Master.
3. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet nga ekspertë të kualifikuar, me tituj e grada shkencore.
4. Stafi akademik tregon vazhdimisht vullnet për kualifikime të mëtejshme, për rritje profesionale dhe për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies. Angazhimi i tyre në fushën e kërkimit shkencor është për t'u vlerësuar, pasi janë gjithnjë aktivë edhe pse u duhet të vetëfinancojnë punën e tyre shkencore.
5. Institucioni ka lidhur marrëveshje shkëmbimi akademik dhe bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, të cilat iu vijnë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve të programit të studimit.
6. Gatishmëria e personelit dhe studentëve për t'u bërë pjesë e programeve të shkëmbimit është në nivele të larta, kështu që lind nevoja për shtim të numrit të tyre. Përvojë mjaft pozitive në këtë kuadër Departamenti i Gjuhës Gjermane ka krijuar me Shërbimin Gjerman të Shkëmbimit Akademik (DAAD).
7. Organizimi i konferencave, seminareve, trajnimeve, leksioneve të hapura me lektorë të huaj dhe aktiviteteve të tjera shkencore.
8. Pajisjet teknologjike inovative në sallat e leksioneve, sallat e konferencave, laboratorët e përkthimit, bibliotekat e pasura fizike dhe virtuale mundësojnë formimin praktik, krahas atij teorik, sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.
9. Krijimi i mundësive për rritjen e jetës sociale të studentëve përmes klubeve dhe grupeve të ndryshme kulturore dhe sportive.

**Pika të dobëta:**

1. Fondet dhe mbështetja financiare për kërkimin shkencor janë shumë të pakta. (Standardi III.4, kriteri 5, fq.33 / Standardi IV.2, kriteri 2; fq.43)
2. Marrëveshjet për shkëmbim akademik me institucione homologe jo në nivel optimal. (Standardi III.1, kriteri 5, fq.27)
3. Mosfunksionimi i platformës software e-student. (Standardi IV.5, kriteret 1,3,4,5; fq.46)
4. Mangësi në gjurmimin e studentëve të diplomuar. (Standardi I.3, kriteri 2, fq.7)


**Rekomandime:**

1. Të shtohen fondet dhe mbështetja financiare nga ana e institucionit për kërkimin shkencor.
2. Të shtohen marrëveshjet me institucione homologe për shkëmbimin akademik dhe mobilitetin e studentëve dhe stafit.
3. Të shtohen përpjekjet për aktivizimin e sistemit virtual e të platformës e-student.
4. Të punohet më tepër në drejtim të ruajtjes së kontakteve dhe të gjurmimit të studentëve të diplomuar.
5. Duhet më tepër përpjekje në drejtim të informimit të studentëve mbi përfaqësimin dhe përfshirjen e tyre në organe vendimmarrëse dhe këshilluese.
6. Studentët duhet të nxiten më tepër për shfrytëzimin e bibliotekave si fizike ashtu edhe virtuale.

**Evaluation conclusions for the study program of the first cycle, Bachelor in the German language of the Higher Education Institution “The University of Tirana” with the relevant profiles: Language and Communication, Linguistics Literature and German Civilization, Translation and Interpretation.**

**Strengths and affirmations:**

1. All the training components of the study program provide the preparation of specialists with linguistic and scientific training and responsible citizens in the service of society, ready for the labor market and to further promote local and national economic development.
2. The rich curriculum of the study program makes it possible for the students to further their studies for the Master’s program.
3. The academic staff of the study program is made up of qualified experts with academic titles.
4. The academic staff shows constant will for further qualifications for professional growth and improvement of the teaching quality. Their commitment in the field of



scientific research is to be valued as they are always active even though they have to self-finance their scientific work.


5. The institution has established academic exchange and collaboration agreements with counterpart institutions inside and outside the country, which helps the academic staff and students of the study program.
6. Students and staff are highly willing to participate in exchange programs, so there is a need to increase their number. In this context the German Language Department has created a very positive experience with the German Academic Exchange Service. (DAAD)
7. Organization of conferences, seminars, training, open lectures with foreign lecturers, and other scientific activities.
8. Innovating technological gadgets in lecture rooms, conference rooms, translation laboratories, and rich physical and virtual libraries provide practical training in addition to the theoretical one, according to the nature, requests and field of the study program.
9. Creating opportunities for the student's social life growth through different cultural and sporting clubs.

#### **Weaknesses:**

1. Funds and financial support for the scientific research are insufficient. (Standard III.4, criteria 5, pg.33 / Standard IV.2, criteria 2, pg.43)
2. Agreements for academic exchange with counterpart institutions are at no optimal levels. (Standard II.1, criteria 5, pg.27)
3. Dysfunction of e-student software. (Standard IV.5, criteria 1,3,4,5, pg.46)
4. Lack of tracking of graduated students (Alumni). (Standard I.3, criteria 2, pg.7)

#### **Recommendations:**

1. The funds and financial supports from the institution for scientific research should be increased.
2. The number of agreements with counterpart institutions for academic exchange and mobility of students and staff should be increased.
3. Increase efforts to activate the virtual system and the e-student platform.
4. To work more in the direction of maintaining contacts and tracking graduate students (Alumni).
5. More efforts are needed to inform students about their representation and involvement in decision-making and advisory bodies.
6. Students should be encouraged to use both physical and virtual libraries.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i përbushjes	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

